



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 9821 /2023

Në bazë të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale numër Nr. 03/L-40 neni 43, nenit 31 të Statutit të Komunës së Hanit të Elezit, bëjë këtë:

**F T E S Ë**

Ftoheni që të merrni pjesë në mbledhjen e njëmbëdhjetë -XI- të rregullt për vitin 2023 të Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet me datë 30.11.2023 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

**RENDI I PUNËS**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti mbi vlerësimin e përgjithshëm për pronat komerciale.
3. Draft Plani i Veprimit për Parandalimin e Dhunës në Familje 2024-2026.
4. Draft Plani i Punës së Ekipës për Mbrojtjen e të Drejtave të fëmijëve 2024-2026.
5. Informatë mbi gjendjen në shëndetësi.
6. Të ndryshme.

**Bashkë me ftesën ju dërgojmë:-**


- Procesverbalin nga mbledhja e kaluar.
- Materialin e raportit mbi vlerësimin e përgjithshëm për pronat komerciale.
- Materialin e Draft Planit të Veprimit për Parandalimin e Dhunës në Familje 2024-2026.
- Materialin e Draft Planit të Punës së Ekipës për Mbrojtjen e të Drejtave të fëmijëve 2024-2026.
- Materialin e informatës mbi gjendjen në shëndetësi.

Hani i Elezit  
Data:-21.11.2023





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr.9822/2023

Data:20.11.2023

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e dhjetë -X- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 31.08.2023 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: **Mehmet Ballazhi** (Kryetar i Komunës), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Kimete Kuka -Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Nexhmedin Daci** (Drejtorja për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), **Sara Berisha** (Asistente e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), **Amir Bushi** (Udhëheqës i Qendrës për Punë Sociale), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Informim), **Rezart Mehmeti** (Përfaqësues i OSB-së), Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Kuvendit të Komunës.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti financiar për periudhën Janar – Shtator 2023.
3. Plani i biznesit të N.P.L Pastrimi sh.a. për vitin 2024.
4. Draft Plani i Veprimit për Parandalimin e Dhunës në Familje 2024-2026.
5. Draft Plani i Punës së Ekipës për Mbrojtjen e të Drejtave të fëmijëve 2024-2026.
6. Propozim vendim për lirim nga taksa administrative për legalizimin e ndërtimeve pa leje për kategoritë e dalura nga lufta.
7. Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit.
8. Raporti financiar për periudhën Janar – Shtator 2023 i N.P.L Pastrimi sh.a.
9. Hartimi i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik 2023/2027.
10. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

**Kryesuesi** thekson:- para se me proceduar me pikën e parë të rendit të punës dëshiroj tu a bëjë me dije disa drejtorëve dhe zyrtarëve të emëruar që nuk është e drejtë dhe as e moralshme të ofendohet asambleja komunale për shkak se asamblistët nuk janë aq të pa rëndësishëm siç mendojnë disa profiter por kanë rol të veçantë dhe të rëndësishëm sepse çdo kërkesë dhe projekt vjen prej asamblistëve dhe kërkohet të votohet. E me ardhur dikush që nuk i dihet forma se si ka ardhur dhe pikërisht me djersën e këtyre asamblistëve dhe potenco se gjoja s'janë lul asamblistët kjo nuk është e drejtë. Kërkojë që të merren masa ndaj këtyre zyrtarëve që janë shkatërrues të shoqërisë dhe të kolegëve këtu sepse nuk është e drejtë kjo.



**Mehmet Ballazhi** thekson:- a është pikë e rendit të punës.

**Kryesuesi** thekson:- është pikë e rendit të punës dhe shumë e rëndësishme.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- pasi është pikë e rendit të punës atëherë hedhe në votim.

**Kryesuesi** thekson:- është e drejtë e imja dhe jam te dhënë si vërejtje, ndërsa e drejta e jote është nëse donë me potencuar diçka mundesh me potencuar, nëse tu ka bërë merak karriga e kryesuesit trego ta lëshoj.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- është mirë me potencuar kur dhe kush e ka ofenduar dikend.

**Kryesuesi** thekson:- të tregon ekipi yt dhe nëse nuk të tregon të tregojë unë për shkak se ty nuk po të tregojnë diçka që është shumë e rëndësishme dhe kjo po më vjen keq.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- kjo çështje nuk është pikë e rendit të punës dhe nuk po e di se kush këndë e ka ofenduar.

**Kryesuesi** thekson:- zyrtari jot të cilët i ke emëruar i ka ofenduar asamblastët komunale dhe po besoj që do ta merresh veshë dhe kërkoj nga ty që të merresh masa.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- ky është kuvend dhe ka rregulla dhe vazhdo me pikat e rendit të punës sepse je tu potencuar diçka pa e ditur se çka ka ndodhur .

**Kryesuesi** thekson:- unë i di rregullat shumë mirë dhe e di se çka ka ndodhur dhe e di se kush ka ofenduar , këtë e ka potencuar personi më i afërt i yti.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- unë të gjithë i kam të afërt dhe kjo çështje nuk po më duket interesante për me diskutuar për shkak se janë pikat e rendit të ditës dhe është kuvend e nuk është odë e burrave dhe nuk është kafe. Pikat e rendit të punës u potencuan dhe nëse donë te të ndryshmet mundesh me potencuar me emër se kush kënd e ka ofenduar.

**Kryesuesi** thekson:- unë e ngrita këtë çështje sepse nuk është e drejtë me ofenduar për shkak se e ofendon qytetarin e vetë.

### 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi** thekson:- a keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

### U MIRATUAR PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

### 2. Raporti financiar për periudhën Janar – Shtator 2023.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Lindita Ballazhi** thekson:- të hyrat vetanake gjatë nëntë mujorit të vitit 2023, të hyrat janë realizuar në shumë prej 292,919.35 € dhe paraqesin 52.2 % të të hyrave të përgjithshme të planifikuara vjetore, ndërsa krahasuar me realizimin e nëntë mujorit të vitit paraprak 2022 kemi një rritje prej 28,490.13 €. Nisur nga vlerësimi i përgjithshëm del se niveli i shpenzimit të buxhetit për këtë periudhë janar-shtator 2023 është në shumë prej 2,125,565.24 € apo 63.46 %. Shpenzimet për paga dhe shtesa shënuan vlerën prej 1,502,955.67 € apo 88.26 %. Shpenzimet për mallra dhe shërbime shënuan vlerën prej 312,224.88 € apo 67.14%. Shërbimet komunale shënuan vlerën prej 56,644.21 € apo 58.69%. Shpenzimet për subvencione dhe transfere arritën shumën prej 64,008.08 € apo 64.00 %. Shpenzimet kapitale arritën vlerën prej 189,732.40€ apo 19.25 %.



**Resul Suma** thekson:- në këtë nëntë mujorë kemi shpenzime kapitale prej 9% më pakë se vitin e kaluar edhe pse e di që janë disa projekte në realizim e sipër a do të mundemi me mbërri 75 % e investimeve kapitale për me aplikuar në grantin e performancës. Tash hymë në sezonin e dimrit dhe projektet nuk mundën me vazhduar për shkak të motit të keq.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- jemi në muajin tetor dhe nesër fillon muaji nëntor, ndërsa jemi tu diskutuar për një raport nëntë mujorë dhe shumica punimeve kanë filluar me vonesë për shkak të procedurave, pra bëhet fjalë për deri në muajin shtatorë ndërsa ne jemi në fund të tetorit dhe shumica e punëve janë kryer duke filluar prej mureve mbrojtëse, parku Bllaca 99, paku Lepenci dhe pagesat nuk janë përfshirë në muajin shtatorë dhe po besojë që ka me tejkaluar 75 % .

**Hyrijete Isufi** thekson:- tash është muaji nëntor dhe dhjetorë a mendoni se nuk ka me u kthyer asgjë suficit.

**Sherif Berisha** thekson:- te mallrat dhe shërbimet te shpenzimet e transportit të nxënësve kemi një rritje të shpenzimeve nga 15000 € në 20000 €, ndërsa në anën tjetër nuk ka zgjidhje për nxënësit të cilët udhëtojnë nga Ferizaji në Han të Elezit. Te shërbimet e ndryshme shëndetësore është një diferencë nga 30€ nga viti paraprakë kemi një shumë prej 3963 € , kërkoj sqarim se për çfarë shërbime bëhet fjalë. Shërbimet e ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse keni ngritje dhe është mirë të sqaroni. Shërbimet e tjera kontraktuese janë në rritje në 49000 € . Te shpenzimet e varrimit nuk kemi asnjë mjetë të shpenzuar nga cila kategori kryhen këto pagesa. Te pajisjet tjera më pak se një mijë euro për çfarë shërbime bëhet fjalë sepse diferenca prej vitit të kaluar është prej 11000 € . Furnizim me ushqim dhe pije është një diferencë e madhe në këtë vit. Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve kemi një rritje prej 5200 € . Te drekat zyrtare është një diferencë prej 10000 € .

**Ajnure Thaçi** thekson:- te kategoria e subvencioneve kemi një rënie prej 5.38 % çka ka ndikuar që është kjo rënie.

**Zaim Bela** thekson:- përqindja për tatimi në pronë dhe tokë po më doket e vogël dhe ata të cilët paguajnë pas afatit paguajnë me dënim. A do të mundemi për me mbërri për me aplikuar për grandin e performancës .

**Mehmet Ballazhi** thekson:- ka rregull se ku mundë të shpenzojmë dhe si mund të shpenzojmë tjetër çështje është mundësi dhe tjetër çështje është vullneti. Ne kemi bërë disa takime me kompanitë e autobusëve për çështjen e nxënësve që i mësojnë në Ferizaj por Ligji e përcakton qartë se kënd mund ta bartin që është obligative për ne. Sa i përket rritjes ju e dini që i transportojmë nxënësit e shkollës së fshatit Krivenik.

**Kimete Kuka -Hasallari** thekson:- dallimi është për shkak që kemi lidhur marrëveshje me Karitasin dhe këto shërbime kryhen si pagesë prej mallrave dhe shërbimeve dhe nuk ka kategori tjetër që mundemi me i paguar.

**Lindita Ballazhi** thekson:- shërbimet e ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse bëhet fjalë për konsulentin në drejtorinë e zhvillimit ekonomikë, për ekspertin e jashtëm që është i angazhuar në tri procedura të rekrutimit, për koreografin e angazhuar për festivalin mbarë kombëtarë Hani i Elezit sesioni i parë, për mësimdhënësen e gjuhës gjermane, psikologjen e angazhuar në QPS. Shërbimi në shumë prej 49000 € ka të bëjë me kontributet dhe tatim punonjësve në listë të pagave, pagesa e një mjeku, pagesa për dezinfektimin dhe deratizimin e institucioneve dhe hapësirave publike, pagesa për Karitasin Zviceran për mjetet didaktike për nevojat e çerdhes, pagesa e pjesëmarrjes në panairin e sportit dhe turizmit, pagesa për hartimin e projekteve për nevojat e drejtorisë së urbanizmit, pagesa për një infermiere për dy muaj, pagesa për zbatimin e marrëveshjes për efqiencë të energjisë, pagesa për analizat e ujërave, pagesa për shërbime të ndryshme te fabrika e ujësjellësit në fshatin Dimcë dhe pastrimin e deponisë së ngurtë në fshatin Paldenicë, pagesa për mësimdhënësen e gjuhës Gjermane, pagesën e gjibiesëve për nevojat e drejtorisë së urbanizmit, pagesa për ingjizimet dhe fotografitë për nevojat e festivalit mbarë kombëtarë Hani i Elezit, pagesa për dyshemetë për



nevojat e sektorit të arsimit, pagesa për shërbimet të cilat i kryen NPL Pastrimi, pagesa për asgjësimin e shiringave, pagesa e kontribuesëve të punonjësve me kontratë në vepër, pagesa për hartimin e projektit të depos së QKMF-së, pagesa për dy infermierët për dy muaj, shpenzimet e varrimit kryhen prej kategorisë së subvencioneve. Te pajisjet e tjera nën një mijë euro janë përfshirë këto pagesa pajisja për evidentimin e vijueshmërisë, pajisje të ndryshme të ajtisë, tabelat informative, kositëse të barit për parqe, filtra të nxemjes qendrore. Furnizimi me pije e jo dreka zyrtare përfshihen këto pagesa ushqimi dhe pije për nevojat e çerdhes, shërbimet e bifësë komunale. Te mirëmbajtja e automjeteve përfshihen këto pagesa për larjen riparimin e automjeteve komunale. Te drekat zyrtare përmes këtij kodit përfshihen këto pagesa mysafirë e Kryetarit të Komunës dhe drejtorive, drek me kontingjentin Italianë, për grupin punues për hartimin e strategjisë për zhvillim ekonomik, për donatorët e paneleve solare në QKMF, drekë me rastin e shtatëmbëdhjetë shkurtit, të ftuarit e kryetarit të komunës nga Maqedonia e Veriu, drekë me kontingjentin Gjerman, dreka për pjesëmarrësit e festivalit mbarë kombëtarë, darkë për veteranët e luftës. Rënia e subvencioneve ka të bëjë që nuk kemi pasur pagesë për lehonitë, apo ndoshta ka pasur më pakë se vitet e kaluara. Deri me datën dy tetor ka qenë afati i fundit për pagesën kështit të dytë të faturës së tatimit në pronë dhe kjo nuk ka ndikuar që qytetarët të ndalen me pagesën e tatimit në pronë, po ashtu kemi edhe marrëveshje të cilat i kemi lidhur me disa qytetarë për pagesë me këste të tatimit në pronë. Sa i përket 75 % do të japim maksimum që ta arrijmë atë përqindje dhe kjo është vetëm nëntë mujorë dhe prej asaj periudhe janë kryer shumë pagesa të tjera.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

### **3. Plani i biznesit të N.P.L Pastrimi sh.a. për vitin 2024.**

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Sevime Bajrami** thekson:- përveç materialit që është dërguar diçka të veçantë nuk kam.

**Resul Suma** thekson:- tarifa e mbeturinave është ngritur në muajin maj të këtij viti, planifikimi i pagave a planifikohet te viti 2024 apo nuk e keni planifikuar. Te pika numër gjashtë është gabim sasia e mbeturinave përbëhet nga mbeturinat e amvisërisë 75 % dhe mbeturinave komunale 35 % që i bien 110 % . A është menduar që në vitin e ardhshëm përveç planifikimit për me i ngritur pagat e punëtorëve me ndërruar edhe mënyrën e pagesës sepse në komunat e tjera pagesën munden me bërë edhe përmes telefonit apo drejtë për drejtë me kartelë .

**Sherif Berisha** thekson:- materialet vinë në komision të aksionarë por unë vërejtje kam sa i përket takimit si komision i aksionarëve sepse që nga viti i kaluar nuk jemi takuar.

**Refet Kalisi** thekson:- a është marr ndonjë hap për ngritjen e pagave a keni biseduar me personat kompetent për këtë çështje. A do të ngritën pagat në vitin 2024.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- do të ngriten pagat për punëtorët e kompanisë për vitin 2024.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U MIRATUA PLANI I BIZNESIT PËR VITIN 2024 I NPL PASTRIMI SH A**



#### 4. Draft Plani i Veprimit për Parandalimin e Dhunës në Familje 2024-2026.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Kimete Kuka -Hasallari** thekson:- materialin e keni dhe nuk po hyjë në detaje por është një draft plan mjaft i rëndësishëm për komunën tonë . Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTU PLANI I VEPRIMIT PËR PARANDALIMIN E DHUNËS NË FAMILJE 2024 -2026 QË TË PËRCILLET PËR DEBAT PUBLIK**

#### 5. Draft Plani i Punës së Ekipës për Mbrojtjen e të Drejtave të fëmijëve 2024-2026.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Kimete Kuka -Hasallari** thekson:- përveç materialit të cilin e kemi përcjell diçka të veçantë nuk kam.

**Amir Bushi** thekson:-është obligim ligjorë që komuna ta ketë një plan të tillë.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTU DRAFT PLANI I PUNËS SË EKIPËS PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE 2024-2026 QË TË PËRCILLET PËR DEBAT PUBLIK**

#### 6. Propozim vendim për lirimin nga taksa administrative për legalizimin e ndërtimeve pa leje për kategoritë e dalura nga lufta.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Nexhmedin Daci** thekson:- propozim vendim ka të bëjë për lirimin nga pagesa e taksës komunale për legalizimin e ndërtimeve pa leje për kategoritë e dalura nga lufta që bëhet fjalë për shtëpitë e kategorisë së parë dhe dytë. Bëhet fjalë për familjet e dëshmorëve, Invalidët e Luftës së UCK-së, vesternët e luftës së UCK-së , viktimat civile dhe familjet e tyre.

**Sherif Berisha** thekson:- propozoj që edhe kategoritë e skemës sociale dhe personat me aftësi të kufizuara të lirohen nga pagesa.

**Zaim Bela** thekson:- kush hyjnë te anëtarët e familje për lirim nga pagesa.

**Nexhmedin Daci** thekson:- këta të cilët janë në skemë sociale janë të liruar me Ligj . Sa i përket lirimit nga pagesa të familjarëve është e paracaktuar me Ligj për kategoritë e dalura nga lufta.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U MIRATU PROPOZIM VENDIMI PËR LIRIMIN NGA TAKSA**



## 7. Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Lindita Ballazhi** thekson:- përveç materialit të cilin e kam përcjell në detaje diçka të veçantë nuk kam.

**Sherif Berisha** thekson:- pse po vijnë faturat e tatimit në pronë pas kohe .

**Lindita Ballazhi** thekson:- këtu ka të bëjë me pagesat po ka rate që faturat i vonojnë operatorët ekonomikë dhe pagesa e tyre llogaritet nga momenti i pranimit në Komunë për shkak se afati ligjorë është tridhjetë ditë për me ekzekutuar pagesën. Në disa raste ka pasur të bëjë me mungesën e buxhetit pasi që buxhetet ndahen në baza mujore dhe ka pasur raste kur jemi ballafaquar me mungesë të buxhetit dhe nuk kemi mundur ta paguaj faturën.

**Refet Kalisi** thekson:- te rekomandimi numër tre a do të ndërmerrni diçka më shumë.

**Lindita Ballazhi** thekson:- jemi munduar në çdo formë me i informuar qytetarët, po ashtu edhe nëpërmjet marrëveshjeve të cilat i kemi lidhur që ato kanë hyrë në obligim Ligjorë, jemi munduar edhe në formë të publikimeve në veb faqe komunale.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

## 8. Raporti financiar për periudhën Janar – Shtator 2023 i N.P.L Pastrimi sh.a.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Refet Kalisi** thekson:- në informatë figurojnë tre teknik në kompani për ku bëhet fjalë.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- kemi një marrëveshje me kompaninë dhe ju e dini që edhe një punëtorë të kompanisë e kemi në komunë dhe jemi të interesuar për me kryer shërbime dhe me qenë transparenca financiare me qenë në rregull .

**Resul Suma** thekson:- a i kanë marr rregullisht shujtat punëtorët e kompanisë dhe a do të vazhdojnë mi marr . Te raporti janë disa gabime teknike te pagat nuk është rënie por rritje.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

## 9. Hartimi i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik 2023/2027.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Majlinda Kaloshi** thekson:- është bërë plotësimi i grupit punues ku janë përfshirë edhe përfaqësues të grupeve parlamentare . Është mbajtur punëtorja për hartimin e këtij dokumenti . Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund ta parashtroni.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.



## 7. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Resul Suma** thekson:- është nënshkruar marrëveshja me Islamik Reliefin për rekrutimin e stafit në QKMF ku kanë mbetur procedurat. A do të hapet konkursi në QKMF për infermierë pasi që është anuluar për mos kompletim të dokumentacionit të kandidatëve . Te projekti i parkut të Lepencit koshin me bërë me zingjirë për shkak se dëmtohet shpejt nëse bëhet me fije. Çështja e ujit është bërë problem. Kur do të fillon pagesa për çështjen e ujit.

**Kimete Kuka -Hasallari** thekson:- sa i përket procedurave me Islamik Reliefin deri me datë 24 tetor ka qenë afati i aplikimit, ka përfunduar dhe tash janë në procedurën e verifikimit të dokumentacionit nga komisioni që është prej Islamik Reliefit. Konkursin për infermierë në QKMF e kemi rishpallur por nga Ministria përkatëse na kanë njoftuar që për shkak të rregullimit të sistemit me ligjin e ri të pagave sistemi i burimeve njerëzore është bllokuar dhe deri sa të na japin leje për zhvillimin e procedurave të më tutjeshme asnjë konkurs nuk është tu zhvilluar.

**Kryesuesi** thekson:- komuna a participonë me mjete financiare në këtë marrëveshje.

**Kimete Kuka -Hasallari** thekson:- komuna participonë dhe për dy vite që e kemi marrëveshjen afër 62000 € participonë.

**Kryesuesi** thekson:- si është e mundur me prtipuar dhe mos me pasur asnjë anëtar në komision.

**Kimete Kuka -Hasallari** thekson:-praktikat të cilat janë bërë në komunë e Ferizajt na kanë paralizuar neve këtu që nuk kemi drejtë me pasur asnjë anëtarë në komision. Janë duke dashur me bërë një konkurs transparentë përparësi kanë kandidatët e komunës së Hanit të Elezit dhe jemi të interesuar me marr shërbime sa më cilësore për qytetarët e komunës sonë.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- janë politikat e mija objektive shërbimi ndaj qytetarëve. Ne kemi bërë një marrëveshje që përparësi në rekrutim të jenë kandidatët nga komuna e Hanit të Elezit dhe ka qenë një far kushti që komuna mos me pasur gisht në përzgjedhje që me u zhvilluar procedurat e rekrutimit sipas kriterëve që ata i plotësojnë . Neve na ka interesuar shërbimi dhe nuk më intereson si mënyrë se kush do të jetë si individë aty por më intereson përzgjedhja e stafit të nevojshëm profesionalë në QKMF . Këto janë objektiva të mijat për shërbime ndaj qytetarëve dhe nuk janë objektiva se kush shkon si individë i caktuar . Unë jam pajtuar për arsye se Islamik Reliefi ka qenë në Han të Elezit dhe arsyetimi që është larguar ka qenë pikërisht kjo që potencohet tash me ndërhyrë nëpër konkurse dhe e kanë potencuar ata vetë që nuk jemi të interesuar me bërë marrëveshje me komuna që na ndërhyjnë në konkurse për me pranuar persona të caktuar dhe unë e kam pranuar me shumë kënaqësi që mos me u përzier në konkurse .

**Kryesuesi** thekson:- unë mendoj që pasi edhe komuna participonë me mjete financiare do të ishte e arsyeshme me pas një rekomandim për një anëtarë të komisionit në mënyrë që me qenë të informuar për shkak se i njohim personat të cilët kanë përvojë më shumë dhe të cilët janë më të kualifikuar dhe që kanë kontribuar edhe në periudhën e pandemisë . Pasi që ne jemi tu participuar me mjete financiare më e arsyeshme do të ishte që me pasur qasje për punëtorët e Hanit të Elezit.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- e kuptojë shqetësimin tendë dhe kërkesën tënde por në objektiva të mia nuk është dhe është vullneti imë se si do të organizohet përzgjedhja e tyre sipas konkurseve se është vullnet që unë e kam nënshkruar atë marrëveshje, unë jap përgjegjësi për atë marrëveshje . Ajo që më ka interesuar prioritet me ju dhënë aplikantëve të cilët janë të Hanit të Elezit.



**Refet Kalisi** thekson:- vetëm mos të vijnë prej komunave të tjera për shkak se ndoshta mund të ketë ndonjë kriter që nuk e përmbushin aplikantët e komunës sonë dhe mund të vijnë prej ndonjë komune tjetër.

**Sherif Berisha** thekson:- edhe pse me vonesë e kam pranuar një përgjigje nga drejtoria e arsimit por nuk jam i kënaqur sepse kam kërkuar raport të detajuar . Projektorët të cilët janë nëpër shumë klasa të shkollave janë jashtë funksionit por e njëjta gjë qëndron edhe me lloptopët . Te salla e sporteve që shfrytëzohet për ushtrime të disa klubeve, të gjitha karrigat janë shkatërruar dhe përgjegjësi e kujt është. Te drejtoria e shëndetësisë tezaku po figuron ende në listë të pagave . A ka mjek në AMF-në e fshatit Gorancë .

**Hisni Luri** thekson:- çështjen e përgjigjeve të cilën e kam dhënë jam i hapur për me biseduar sepse ende kemi paguar fatura për shkak se planifikimet kur janë bërë mjetet financiare janë marr nga katër apo pesë drejtori . Sa i përket projektorëve dhe lloptopëve jemi me një rrugë që po duam me i hequr projektorët sepse po shkojmë drejtë digjitalizimit dhe kabllot të cilat janë në defekt jam i angazhuar me drejtorët e shkollave , ndërsa sa i përket lloptopëve jemi duke e pritë një grand nga Ministria e Arsimit , i kemi plotësuar formularët dhe jemi tu pritë prej Ministrisë së Arsimit për me na furnizuar. Sa i përket defekteve ata kanë qenë të prishura më herët se sa është miratuar rregullorja. Kërkesë kemi bërë që me i ndërruar dhe me vendosur ndryqim sa më profesional te salla e sporteve te shkolla fillore “Ilaz Thaçi”.

**Kimete Kuka -Hasallari** thekson:- po më vjen keq që mu drejtove me tezak se tezaku në marrëdhënie pune ka qenë para se të vijë unë drejtoreshë dhe nuk kam kompetencë me larguar dikend nga lista e pagave për deri sa është duke i shfrytëzuar pushimet që ligjërisht i takojnë. AMF-ja në fshatin Gorancë nuk ka mjek vetëm me infermier po mbahet dy herë në javë dhe me plotësimin e stafit nga Islamik Reliefi do të jetë mjeku dy herë në javë.

**Hanumshahe Dibrani** thekson:- sot është afati fundit te kufiri për demolimin e lokale por çka do të ndodhë më tutje.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- deri sot është afati por nuk duam me shfrytëzuar mundësinë ligjore apo pushtetin për me potencuar se po bëjmë diçka por po duam me ngritur vetëdijen e secilit qytetarë aty ku mundemi për me arritur me bërë diçka në Han të Elezit . Afatin e kanë deri sot dhe prej nesër ne nuk marrim përgjegjësi, të gjitha shpenzimet çfarëdo që ndodhë dhe të gjitha dëmet i bartin ata se është çështje tyre se ka instanca tjera sepse kompania mundë të ja fillojnë punimet dhe ata mund të mos u largojnë dhe pastaj shkon policia, komuna nuk ka punë këtu për shkak se i kemi udhëhequr procedurat ligjore administrative. Neve na intereson që kompania me kryer punë dhe është çështje e kompanisë se si i zhvillon punimet.

**Zaim Bela** thekson:- nga drejtori për arsim kërkoj informacion për numrin e nxënësve. Kam kërkuar që të publikohet lista për punëtorët të cilët punojnë në institucionet publike a e kanë paguar tatimin në pronë . Rruga që është filluar te lagjia Ramuk a i mbikëqyrë punë kryesin dikush për shkak se gypin nuk e mbulofshin me rërë ashtu siç janë standardet. A ka të interesuar për shpalljen që është bërë për subvencionimin e fermerëve të cilët kanë mbjell grurë.

**Hisni Luri** thekson:- pyetja ka qenë se sa është numri i nxënësve në rënie për vitin 2022 -2023 të vitit akademik që e kemi pasur vitin e kaluar ka qenë 105, ndërsa numri për vitin 2023-2024 të regjistruar është 82

**Lindita Ballazhi** thekson:- nuk e di sa kemi bazë ligjore për ta përgatitur listën e zyrtarëve të cilët nuk e kanë paguar tatimin në pronë por kemi ndërmarr disa hapa që kam kontaktuar me departamentin e tatimit në pronë si dhe me agresionin për privatësi .

**Majlinda Kaloshi** thekson:- obligimet e pa paguar që bizneset i kanë Komunës janë në shumë prej 286 738.40 €. Faturimin të cilin e kemi bërë për vitin 2023 është në shumë prej 97 079.74 € , ndërsa inkasimin të cilin kemi mundur me mbledhur deri në muajin shtatorë është në shumë prej 75487 .44 €



**Arsim Dernjani** thekson:- sa i përket çështjes së ujit për çdo ditë jam në kontakte me kompaninë "Bifurkacioni" dhe janë duke i kryer punimet punëtorët e kompanisë "Bifurkacioni" por po kanë edhe vështirësi gjatë vendosjes së orëmatësve. Kjo javë ka qenë më mirë sa i përket furnizimit për shkak se jam në kontakte me qytetarët.

**Kryesuesi** thekson:- është mirë që qytetari me ditur që pagesa për çështje të ujit a do të fillon prej momentit që merret ndonjë vendim apo prej vendosjes së orëmatësit . Është mirë të dihet kjo çështje.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- çështja e pagesës është e kompanisë "Bifurkacioni por na kemi kërkuar që me hyjë në pagesë. Orët janë vendosur dhe janë tu faturuar me këtë numërim por kur fillon faturimi nuk e dimë por vështirësitë që i përmendi drejtori që janë në teren po besoj që edhe ju i keni parë sepse ka probleme.

**Refet Kalisi** thekson:- kryetarin e dëgjova dhe e kuptova shumë mirë por drejtorin nuk e kam kuptuar sepse para dy muaje drejtori ka potencuar që atë ditë që vendosen të gjitha orët do të hynë në pagesë por unë e shohë ashtu siç potencoj kryetari . Mu më është vendosur ora dhe regjistron dhe numrat do të merren nga ajo ditë që është vendosur ora , ndërsa prej drejtorit kemi pranuar tjetër përgjigje.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- drejtori mundet me potencuar por është çështje e kompanisë dhe nuk e dimë se çfarë vendimi merr kompania sepse çështja jonë është me mbështetur kompaninë për futje në menaxhim të ujit dhe nuk mundemi me marr vendim në emër të kompanisë . Shqetësimet e juaja do t'i diskutojmë me përfaqësuesit e kompanisë "Bifurkacioni". Unë do të bisedojë me përfaqësuesit e kompanisë që ata me dal me një njoftim zyrtarë se kur do të fillon pagesa e ujit.

**Kryesuesi** thekson:-nuk është mirë me i lënë një far komoditeti kompanisë "Bifurkacioni" që me ngarkuar qytetarin e komunës së Hanit të Elezit me një tarifë që ndoshta nuk i ofron ujë apo ja ofron ajrin. Është një përmirësim i mirë por nuk duhet t'i lihet komoditeti kompanisë "Bifurkacioni që ata me vendosur për shkak se kritikata po adresohen në komunë .

**Abduraman Bushi** thekson:- deri para se me filluar mbledhja numri i fermerëve që kanë aplikuar është 26.

**Ibadete Kalisi** thekson:- kam dëgjuar disa ankesa nga banorët e komunës sonë që në komunën tonë nuk po ofrohen disa shërbime. Nëse unë dëshirojë me ndryshuar emrin, pse në komunën tonë nuk ofrohet ky shërbim. Në QKMF ka ankesa për punëtorin e radiologjisë që nuk është duke i kryer shërbimet e tij për shkak se me datë nëntëdhjete isha në QKMF dhe nuk ka qenë prezent.

**Natyra Kalisi** thekson:- këtë përgjigje do ta mundohem me dhënë në kuvendin e radhës.

**Kimete Kuka -Hasallari** thekson:-do të marr informacionin prej QKMF-së dhe do të jap përgjigje.

**Emine Luri** thekson:- ka disa ankesa që në shkollën e mesme Dardania mësimi nuk po zhvillohet ashtu siç duhet si shkaktarë disa nxënës shumë problematik të cilët kanë qasje shumë të keqe ndaj profesorëve . A ka ndër marr drejtoria ndonjë masë ndaj tyre sepse kjo qasje ka arritur deri në atë nivel që disa profesorë e kanë lënë orën e mësimi.

**Erblin Meliqi** thekson:- kur është borxhi i tatimit a llogaritet kamata në tërësi apo vetëm viti aktual .

**Hisni Luri** thekson:- çdo herë kemi pasur nxënës të cilët kanë sjellje problematik edhe për këto drejtoria e shkollës merr masa e përjashton por nuk kam qef me i përmendur këtu jo për këtë rast sepse ju e dini që kemi qenë në gjendje komplet një klasë për me i përsëritur por përsëri me na bërë presion që me i pranuar të njëjtit për shkak se janë fëmijët e tonë. Për këto nxënës merren vërejtje nga drejtori i shkollës dhe nëse vijnë në komunë ne i ekzekutojmë.



**Lindita Ballazhi** thekson:-sa i përket kamatës së tatimit në pronë nëse keni borxhe të vitit paraprakë dhe nëse nuk e keni paguar kamat do të ketë edhe për atë vit por edhe për vitin aktual.

**Resul Suma** thekson:- dje kemi pasur mbledhje të Komitetit për Komunitete por në dy apo tri mbledhje një pjesë e drejtorëve i neglizhojnë dhe nuk marrin pjesë në takimet të cilat mbahen që pika diskutuese është për ata drejtorë . Është mirë me marr pjesë nëpër takimet por edhe imellat me ua përcjell zyrtarëve përgjegjës.

**Sherif Berisha** thekson:- do të qasem te fillimi i takimit të sotëm për çështjen e fyerjes sepse është e vërtetë që nuk mundet ta konteston askush se ka ndodhë dhe këta shqetësime i kam shprehur edhe më herët dhe nëse përsëri paraqiten personalisht po flasë për vete me ato mundësi të cilat i kam do ti kthehem dy apo tri herë më shumë, kushdo që është masa disiplinore ka ekzekutivi i komunës dhe është mirë me i marr që mos me na detyruar me i marr prej asamblesë komunale.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- nëse keni konkretisht për ndonjë drejtor apo drejtoreshë është mirë me potencuar dhe nuk është mirë në mënyrë hipotetike me potencuar për shkak se nuk janë çështje parlamentare sepse mund t'i diskutojmë por sa personi më shanë mu rrugëve nuk kam kohë dhe energji me u marr, i shohë edhe në fesbuk por nuk ua kthej komentet për shkak se është çështje tyre me shah, fyer dhe me nënvlerësuar, është kulturë dhe edukatë e gjithë secilit, e me u nis me marr më këto, asnjë punë nuk mundem me bërë . Nëse ka konkrete për ndonjë diçka që e ka shkelur Ligjin apo rregullore. Nëse flitet që e kam dëgjuar apo se kam dëgjuar në bazë të cilit ligj dhe rregullore me marr masa apo vetëm po doni se duhet për një qef të dikujt. Për mu deri tash drejtorët dhe drejtoreshat janë një qind për qind në përputhje me objektivat e mia , s'janë perfekt as nuk janë engjuz por në objektivat e mia janë në përputhje me ato që e bëjnë përkushtimin. Për defekte të caktuara për mangësi të caktuara duke u nisur prej meje dhe gjithë secilit që jemi si njerëz janë çështje që diskutohen e jo në këtë formë me i bërë tema të pa tema .

**Sherif Berisha** thekson:-unë kam kërkuar edhe për iks personi se si është qëndrimi jot ndaj tij nuk më ke dhënë përgjigje pra ka qenë rast konkretë .

**Mehmet Ballazhi** thekson:- e maj mend dhe të njëjtë pyetje ta ka parashtruar dikush që me dhënë përgjigje ti se a janë kafshë apo nuk janë kafshë, a janë roje apo nuk janë roje të kafshëve aty në park që edhe dikush ta ka bërë këtë pyetje por nuk ju ke përgjigjur dhe drejtorët dhe drejtoreshat në objektivat e mija janë një qind për qind të përkushtuar.

**Kryesuesi** thekson:- është e vërtetë që këto objektivat e tua po i dërgojnë në vend por për mua është shqetësim kjo sepse nuk është e drejtë e drejtorit me ardhur dhe me ofenduar dikend këtu , më vjen shumë keq prej teje kryetarë se ti nuk je i informuar . Nuk ka autoritet dikush me potencuar që lul asambleja që është kjo, kenë qysh kenë kanë dalur dhe e kanë matur veten dhe nëse i doket dikujt që s'janë kërkushi ne del para popullit sepse janë tu e ofenduar qytetari . A e donë dikush dikën apo nuk e donë apo a e ka për qefi apo nuk e ka është diçka tjetër për shkak se njeriu shoqërinë e zgjedhë vetë dhe me kënd donë mundet me nejtë por ofendimet fjalët pas shpine nëpër zyre nëpër drejtori nuk është e drejtë se zbehet kolektiviteti këtu. Nuk mundemi me një shoqëri kaq të vogël këtu në komunë gjërat me shkuar kështu nuk ka vullnet pune as harmoni të bashkëpunimit.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- i nderuar kryesues unë po të kuptoj por çka vijën dhe dëgjojë se potencojnë që kryesuesi i kuvendit e shanë me rob drejtorin dhe nuk di pse duhet me ja sha robt dikujt dhe nëse dikush potencon për mu që mi ka shahë robt në rrugë , unë nuk merrna më kësi sene kryesues.

**Kryesuesi** thekson:- është e vërtetë por ku e din ti se çfarë marrëdhënie kam me drejtorin në fjalë, është dashur me pyet drejtorin dhe nuk duhet me u marr me propaganda të drejtoreshave dhe është dashur me thirr kryesuesi dhe me pyetur se çka është problemi e jo me propaganda të lloj lloj rrogzine. Por kryetar t'i e ke një pikë të dobët për shkak se si të thojnë drejtoreshat diçka ti e beson me një herë. E ke edhe një aftësi krejt gjërat i organizon tana kthehesh e ta drejton gishtin por për mu pak punë është e di të vërtetën.



**Mehmet Ballazhi** thekson:- nuk e kam thirr drejtorin për këtë punë dhe nuk është etike me përdorë fjalën rrogzinë dhe nuk banë me u kapur sepse secili e ka mendimin e vlerësimit për dikend sepse për ty mund të jetë e drejtë diçka për tjetrin nuk kana e drejtë diçka por janë mendime të secilit dhe askujt nuk i kam thanë diçka që më ka sha në rrugë edhe pse e di që më kanë shahë por është çështje kulturës dhe e edukatës së tij.

**Malik Berisha** thekson:-te parku te AMF-ja në fshatin Gorancë nuk e di a është bërë pranimi teknik i punës sepse i pashë disa gabime të vogla por besoj që gjatë pranimi teknik rregullohen.

**Nexhmedin Daci** thekson:- ka pasur me u bërë pranimi teknik po nuk kam informacione sigurt a është bërë. Sugjerime i kam dhënë për me i përmirësuar disa gabime.

**Kryesuesi** thekson:- a keni caktuar zonë për mbeturinat e ngurta ju si drejtori e urbanizmit e keni për detyrë ta caktoni lokacionin për hudhjen e mbeturinave të ngurta , ndërsa drejtorja e shërbimeve publike e ka për detyrë ta menaxhon.

**Nexhmedin Daci** thekson:- ende nuk e kemi caktuar.

**Refet Kalisi** thekson:- kompania e cila është duke i kryer punimet te rruga për kanalin e hapur a ka sjell mjete të tjera apo vetëm ata i ka.

**Nexhmedin Daci** thekson:- e drejtorisë është për me dorëzuar në zyre të prokurimit projektin dhe pastaj janë procedura të tjera. Ajo kompani ka dal më e lira dhe e ka fituar tenderin dhe e ka kontratën nëse e respekton është në rregull nëse nuk respekton futet në penale.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 13:13.

Procesmbajtësi  
Avni Bushi

Kryesuesi i Kuvendit  
Florim Shkreta







REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA - MUNICIPALITY  
HANI I ELEZIT



Nr. 04/ 9551 /2023

DATA :	07.11.2023
PËR :	KPF dhe Kuvend Komunal
PËRMES :	<i>MB</i> <b>Mehmet Ballazhi</b> Kryetar i Komunës së Hanit të Elezit
NGA :	<b>Lindita Ballazhi</b> <i>Ballazhi</i> Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
LËNDA :	<b>Raport mbi vlerësimin e përgjithshëm për prona komerciale</b>



Të nderuar,

Në përputhje me nenin 18, paragrafi 5 dhe 6 i Ligjit Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Departamenti i Tatimit në Pronë – Ministria e Financave, Punëve dhe Transfereve ka nxjerr raportin për Komunën Hani i Elezit mbi vlerësimin e përgjithshëm të pronave të paluajtshme, për kategorinë e pronave komerciale (tokë dhe objekte), në kuadër të të cilit janë përcaktuar zonat e vlerave dhe nivelet e vlerave të pronave të paluajtshme që janë brenda territorit të Komunës, në përputhje me nenin 17, paragrafi 1 i Ligjit Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ MF-NR. 08/2019 për Metodologjinë e Vlerësimit për Qëllime të Tatimit në Pronë, neni 19, Nivelet e Vlerave.

Me respekt,



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije Ministry of Finance Arkiva - Arhiva - Archive			
Nr. i Org. Org. Jedin. Org. Unit	09/463	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	935/2023
Nr. i Kopjeve Bros. Stranica No. pages	7	Data Datum Date	24.10.23
Prishtinë/A			



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -**  
**Ministry of Finance, Labour and Transfers**

*Departamenti i Tatimit në Pronë - Departman poreza na imovinu - Property Tax Department*

<b>DATË/A:</b>	23.10.2023
<b>REFERENC-Ë:</b>	
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Mehmet BALLAZHI, Kryetar i Komunës, Hani i Elezit Lindita BALAZHI, Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	
<b>CC:</b>	Hekuran MURATI, Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve Enis SPAHIU, Zv. Sekretar i Përgjithshëm
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Albana SHALA BUNJAKU, Zv. Drejtoreshë e Departamentit të Tatimit në Pronë Qesere BAJRAMI, Udhëheqëse e Divizionit VSZHP
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Raporti mbi vlerësimin e përgjithshëm për Prona Komerciale



Të nderuar/a,

Departamenti i Tatimit në Pronë në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve në përputhje me nenin 18, paragrafi 5 dhe 6 i Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, ka nxjerrë raportin për Komunën e Hanit të Elezit mbi vlerësimin e përgjithshëm të pronave të paluajtshme, për kategorinë e pronave Komerciale (tokë dhe objekte) në kuadër të të cilit janë përcaktuar zonat e vlerave dhe nivelet e vlerave të pronave të paluajtshme që janë brenda territorit të komunës, në përputhje me nenin 17, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ MF-NR. 08/2019 për Metodologjinë e Vlerësimit për Qëllime të Tatimit në Pronë, neni 19, Nivelet e Vlerave.

Raporti i vlerësimit të përgjithshëm gjithashtu është nxjerrë pas kryerjes së vlerësimit për të përcaktuar nivelet e vlerave për: Parcelë për objekt komercial, Parcelë për rekreacion komercial, Parcelë transport komercial, Shitore, Zyrë, Restorant, Hotel, Objekt për magazinim komercial, Garazh komerciale, Pishinë për shfrytëzim komercial, Fushë e hapur sportive, Fushë e mbyllur sportive, Pompë benzine, Objekt tjetër komercial, kategori këto të përcaktuara në përputhje me nenin 5 të UA MF-Nr. 08/2019 për Metodologjinë e Vlerësimit për Qëllime të Tatimit në Pronë, neni 19, Nivelet e Vlerave.

Gjatë procesit të vlerësimit në masë të pronave të paluajtshme komerciale janë analizuar kontratat e shitblerjeve të cilat janë përfaqësuese për llojin e tregut që vlerësohet, atë komercial, janë bërë



anketa me qytetarë lokal të zonave aktuale, janë zhvilluar takime me përfaqësuesit e komunave për të marrë opinionet/sygjërimet e tyre rreth niveleve të vlerave.

Si rrjedhojë, në mungesë të shifjeve në disa raste, përveç derivimit të vlerave kemi aplikuar edhe qasjen e simulimit të vlerave të tregut duke aplikuar koeficient për zona dhe nivele të vlerave për të derivuar nivelin e vlerës nga kategoritë kryesore të vlerës në kategoritë tjera.

Për qëllime të tatimit në pronë aplikohet vlerësimi në masë i pronave të paluajtshme, ku pronat brenda një zone të caktuar gjeografike, të së njëjtës kategori vlere, kanë vlera tregu të përafërta e që nënkupton se niveli i vlerës është i njëjtë në atë zonë vlere të caktuar.

Raporti mbi vlerësimin e përgjithshëm (bashkëngjitur kësaj shkrese) përmban informacionin si vijon:

- emrin e Komunës;
- datën e nxjerrjes;
- nivelin/nivelet e vlerës/vlerave për çdo zonë vlere;
- hartat e zonave të vlerave; dhe
- një përshkrim të çdo zone vlere.

Me respekt!





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve*  
*Ministarstvo za Finansije, Rada i Transfera – Ministry of Finance, Labor and Transfers*

*Departamenti i Tatimit në Pronë-Odeljenje za Poreza na Imovinu-Department of Property Tax*

---

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË PËRGJITHSHËM**  
**PRONAT KOMERCIALE**  
**KOMUNA HANI I ELEZIT**

**Prishtinë, 23.10.2023**



## TERMINOLOGJIA E PËRDORUR NË RAPORTIN MBI VLERËSIMIN E PËRGJITHSHËM

**Vlerësim i përgjithshëm** - nënkupton procesin e vlerësimit të pronave të paluajtshme, përmes të cilit vlerësohen brenda një periudhe të caktuar kohe, me ndihmën e një metodologjie standarde dhe vlerësimit të të dhënave të grumbulluara të tregut dhe të dhënave të tjera të nevojshme, të gjitha pronat e paluajtshme në të njëjtën kategori prone;

**Vlerë e tregut** - nënkupton shumën e përafërt të vlerësuar për të cilën një pronë do të shkëmbehej në datën e vlerësimit, mes një shitësi dhe blerësi të vullnetshëm, përmes një transaksioni ku ata nuk kanë lidhje me njëri tjetrin dhe pasi të jetë bërë marketingu i duhur ku secila nga të dyja palët ka vepruar në mënyrë të vetëdijshme, me maturi dhe pa ndonjë detyrim;

1. **Metoda e vlerësimit:** Metoda e krahasimit të shitblerjeve dhe simulimi i vlerës së tregut.
2. **Burimi i informatave:** Kontratat e shitblerjes nga AKK (përfaqësuese për zonën paraprake), anketa me qytetar, intervista me agjentë të shitjes, intervista me zyrtar bankash, vlerat e pronave që janë shpronësuar, ofertat në shitje si dhe informacione tjera relevante të tregut.
3. **Niveli i vlerës:** Nivel i derivuar i vlerës.

**Kategoria e vlerës:** Zyre

1. **Metoda e vlerësimit:** Metoda e krahasimit të shitblerjeve dhe simulimi i vlerës së tregut metoda e te hyrave.
2. **Burimi i informatave:** Kontratat e shitblerjes nga AKK (përfaqësuese për zonën paraprake), anketa me qytetar, intervista me agjentë të shitjes, intervista me zyrtar bankash, vlerat e pronave që janë shpronësuar, ofertat në shitje si dhe informacione tjera relevante të tregut.
3. **Niveli i vlerës:** Nivel bazë i vlerës

**Kategoria e vlerës:** Shitore, Restorant, Hotel, Objekt për magazinim komercial, Garazhë komerciale, Pishinë për shfrytëzim komercial, Fushë e hapur sportive, Fushë e mbyllur sportive, Pompë benzine, Objekt tjetër komercial.

1. **Metoda e vlerësimit:** Metoda e krahasimit të shitblerjeve dhe simulimi i vlerës së tregut metoda e te hyrave.
2. **Burimi i informatave:** Kontratat e shitblerjes nga AKK (përfaqësuese për zonën paraprake), anketa me qytetar, intervista me agjentë të shitjes, intervista me zyrtar bankash, vlerat e pronave që janë shpronësuar, ofertat në shitje si dhe informacione tjera relevante të tregut.
3. **Niveli i vlerës:** Nivel i derivuar i vlerës

**Përgatitur nga:**

Valon Januzi - Vlerësues i Pronave të Paluajtshme Shkalla e Parë - A

(VPP-410)

Gentrit Kadrolli - Vlerësues i Pronave të Paluajtshme Shkalla e Parë

(VPP-397)

Vllaznim Vuçitërna - Ekspert i Gjeodezisë

Qyrsere Bajrami - Udhëheqëse e Divizionit për Vlerësime, Standarde, Zhvillim dhe Programe

Albana Shala Bunjaku - Ud. Drejtoreshë e Departamentit të Tatimit në Pronë





# **Komuna Hani i Elezit**

## **PLANI I VEPRIMIT PËR PARANDALIMIN E DHUNËS NË FAMILJE - MEKANIZMIT ( 2024 – 2026 )**

**Tetor 2023**

**Lajmërimi i rasteve të dhunës në familje**

**Kontaktet:**

**Policia e Kosovës – Hani i Elezit - 192**

**Qendra për Punë Sociale – Hani i Elezit – 03820046571**

**Thirrjet emergjente - 122**

## **Falënderim**

Hartimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje ishte përpjekje e përbashkët e Grupit Punës për hartimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, nën koordinimit të kordinatorit të Mekanizmit Kundër Dhunës në Familje në Han të Elezit, me përkrahjen e misionit të OSBE në Kosovë dhe një spektri të gjërë të partnerëve.

Komuna e Hanit të Elezit gjithashtu vlerëson lartë punën dhe përkushtimin e zyrtarëve në kuadër të ZBGJ, QKMF, QPS, OJQ-ve, Gjykatën dega në Kaçanik, Policia e Kosovës, Strehimores “Shtëpia Ime”, po ashtu, falënderon veçanërisht institucionet komunale (drejtoritë komunale) për kontributin që kanë treguar dhe OSBE për mbështetje.

Strategjia dhe Plani i Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje është një prej dokumenteve më të rëndësishme të Komunës së Hanit të Elezit, hartimi i së cilës ka ndjekur një proces të gjatë diskutimesh dhe kontributesh konkrete të shumë institucioneve relevante që punojnë në këtë fushë. Përfshirja dhe kontributi i tyre kanë dhënë frytin e punës që gjendet në faqet e këtij dokumenti për parandalimin e dhunës në familje në komunën tonë.

### **Shkurtesat:**

**BE - Bashkimi Evropian**

**DKA – Drejtoria Komunale e Arsimit**

**DHBGJ - Dhuna në Baza Gjinore**

**DHF - Dhuna në familje**

**MAPL - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal**

**MM - Memorandum mirëkuptimi**

**MV - Mbrojtës i Viktimave**

**OJQ - Organizata Joqeveritare**

**OSBE - Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë**



**PK – Policia e Kosovës**

**PSV - Procedurat standarde të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje**

**QAP - Qendra e aftësimit profesional**

**QMF – Qendra e Mjekësisë Familjare – Hani i Elezit**

**QPS - Qendrat për Punë Sociale – Hani i Elezit**

**KBI – Kshilli i Bashkësisë Islame – Hani i Elezit**

**QRK – Qeveria e Republikës së Kosovës**

**UA - Udhëzim Administrativ**

**ZKBJGJ - Zyrtarët Komunalë për Barazi Gjinore**

**ZPK – Zyra e Punësimit – Hani i Elezit**

**Përmbajtja**

**I. Përmbledhje ekzekutive**

**II. Hyrja**

**III. Metodologjia**

**IV Sfondi –Analiza e gjendjes**

**4.1. Analiza e përgjithshme e situatës së dhunës në familje**

**4.2. Analiza e situatës së dhunës në familje në Komunë**

**4.3. Pasojat më të theksuara të dhunës në familje**

**V. Objektivat Strategjike**

**VI. Plani i Veprimit**

**VII. Aranzhimet e zbatimit, monitorimit dhe raportimit**

**7.1. Mekanizmat zbatues**

## 7.2. Mekanizmat monitorues dhe raportues

### I. Përmbledhje ekzekutive

Dhuna në familje është vepër penale<sup>1</sup> dhe fenomen që lëkund vlerat e shoqërisë demokratike. Kushtetuta e Republikës së Kosovës<sup>2</sup> në kuadër të parimeve të saj, mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, duke i konsideruar ato si të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme.

Me qëllim të parandalimit dhe ngritjes së efikasitetit të trajtimit të rasteve të dhunës në familje, duke synuar plotësimin e standardeve për ofrimin e mbrojtjes së duhur viktimave të dhunës në familje, në pajtim me Konventën e Stambollit, është hartuar Ligji për Mbrojtje nga dhuna në familje, që “dhunën në familje”<sup>3</sup> e përkufizon: “veprim apo mosveprim i qëllimshëm që rezulton me abuzim, kur kryhet nga një person që është apo ka qenë në marrëdhënie familjare me viktimën”.

Duke u bazuar në obligimet që rrjedhin nga korniza ligjore dhe standardet ndërkombëtare, mbështetur në masë të gjerë në Strategjinë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje/politikat nacionale dhe Programin e Kosovës për Barazi Gjinore (2020 – 2024), që njëherit paraqet një vazhdimësi logjike të përkushtimit të institucioneve qeveritare për një zgjidhje funksionale dhe efektive për parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje dhe eliminimin e pabarazive e shtrirë në nivel lokal, Kuvendi Komunal i Hanit të Elezit nën koordinimin e Mekanizmit Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, me përkrahjen e OSBE në Kosovë ka hartuar “Strategjinë Komunale dhe Planin e Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje”.

Duke dënuar të gjitha format<sup>4</sup> e dhunës në familje dhe bazuar në jetësimin e parimit të Kartës së Kombeve të Bashkuara “*Të drejta të barabarta për burrat dhe gratë*”<sup>5</sup>, strategjia është e përqendruar në fuqizimin dhe funksionalizimin e Mekanizmit Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, në përputhje me përgjegjësitë e tyre të përcaktuara në kuadër të

<sup>1</sup> Kodi nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, neni 248;

<sup>2</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitulli II;

<sup>3</sup> Ligji nr. 03/L-182 për mbrojtje nga dhuna në familje, Kuvendi i Kosovës, neni 2.1(1.1): E definojnë si të tillë mes personave që janë/kanë qenë: të fejuar, të martuar; në bashkësi jashtëmartesore; bashkëjetojnë në ekonomi të përbashkët, si dhe përdorin një shtëpi të përbashkët dhe janë në lidhje gjaku, martesë, adoptimi, krushqie apo janë në lidhje kujdestarie, duke përfshirë prindërit, gjyshërit, fëmijët, nipat, vëllezërit dhe motrat, hallat e tezet, xhaxhallarët e dajallarët ose kushërinjtë, janë prindër të një fëmije të përbashkët, janë palë procedurale në një kontest nga marrëdhëniet familjare: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-182-eng.pdf> 2;

<sup>4</sup> Dhuna në familje, dhuna fizike, psikologjike, seksuale dhe ekonomike, për nevojat e kësaj strategjie do të jetë e njëjtë siç është përkufizuar në dispozitën e nenit 2, nën paragrafi 1.2. të Ligjit nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje;

<sup>5</sup> OKB, Karta e Kombeve të Bashkuara, neni 1, 1945;

Marrëveshjes së Mirëkuptimit<sup>6</sup>, kornizës ligjore në fuqi dhe obligimeve që rrjedhin nga Konventa e Stambollit për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, duke synuar rritjen e koordinimit efektiv dhe bashkërendimin e veprimeve në minimizimin e fenomenit të dhunës në familje dhe mbrojtjen e viktimës së dhunës.

Synim ky që parashihet të realizohet duke adresuar me prioritet fushat e veprimit të strategjisë:

#Përmirësimi i sistemit institucional për parandalim dhe ofrim të shërbimeve cilësore për mbrojtje nga dhuna në familje;

# Përmirësimi i qeverisjes lokale për parandalimin dhe mbrojtje nga dhuna në familje;

# Fuqizimi i shërbimeve rehabilituese dhe riintegruese të viktimave të dhunë në familje;

Qasja strategjike e të cilit është që me anë të objektivave të qarta dhe aktiviteteve specifike, të ndihmojë Mekanizmin Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në fuqizimin e tyre për përmbushjen e përgjegjësiwe institucionale karshi institucioneve që përfaqësojnë në këtë trup institucional dhe përgjegjësiwe që rrjedhin themelimi i tyre. Njëherit, kërkon sigurimin e zbatimit të kornizës ligjore, politikave nacionale dhe standardeve ndërkombëtare për parandalimin, identifikimin pro-aktiv dhe luftimin e dhunës në familje, si dhe reagimit të menjëhershëm dhe të vazhdueshëm në ofrimin e shërbimeve cilësore për mbrojtje dhe trajtim të rasteve të dhunës në familje. Po ashtu, synon që duke marrë masa efektive në rritjen e koordinimit dhe bashkërendimit të veprimeve në mes të akterëve relevantë, të nxitet përparimi shoqëror ku shoqëria është e vetëdijshme dhe mbështetëse e të drejtave të njeriut për të qenë të lirë nga të gjitha format e dhunës që promovon fuqizimin social dhe ekonomik të vajzave dhe grave dhe dhuna në familje të bëhet e papranueshme në komunitetin tonë.

Bazuar në frymën e Konventës së Stambollit që pranon se dhuna gjinore ndaj grave përbën “shkelje të rëndë të të drejtave të grave dhe vajzave dhe pengesë kryesore për arritjen e barazisë midis burrave dhe grave”<sup>7</sup>, strategjia në brendësinë e saj përfshinë perspektivën gjinore duke përcaktuar masa konkrete në kuadër të planit të veprimit për fuqizimin e gruas dhe arritjen e barazisë midis burrave dhe grave.

Të bindur se investimi në kapital njerëzor nuk është vetëm gjëja e duhur për të bërë nga pikëpamja etike dhe morale, por është gjithashtu gjëja më e mençur të bëhet nga pikëpamja ekonomike për njerëzit, familjet e tyre, komunitetin, shoqërinë dhe shtetin në përgjithësi. Në këtë kuptim, strategjia adreson edhe parimet dhe dimensionet e traktateve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, veçanërisht të Konventës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, si:

---

<sup>6</sup> Marrëveshje Mirëkuptimi për Institucionalizimin e Mekanizmit Koordinues Kundër Dhunës në Familje dhe Mënyrën e Funkcionimit të të tij , në Komunën e Hanit të Elezit më datë 06.12.2018

<sup>7</sup>Këshilli i Europës, Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, preambula, 2011;



# dinjiteti njerëzor<sup>8</sup>;

#barazia në mes grave dhe burrave<sup>9</sup>;

# mos-diskriminimi<sup>10</sup>;

# moskthimi<sup>11</sup>;

duke kërkuar që jetesa në komunitet të zhvillohet bazuar në respektimin eshtetit të së drejtës, të drejtave të njeriut, të drejtave të barabarta për burra dhe gra dhe respektimin e demokracisë.

Strategjia dhe Plani i Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje për Komunën e Hanit të Elezit, mundëson edhe koordinimin e përpjekjeve ekzistuese të të gjitha departamenteve dhe institucioneve qeverisëse komunale dhe të organizatave joqeveritare, duke angazhuar struktura të ndryshme publike dhe private, për të diskutuar dhe zgjidhur çështjet të ndryshme si ato të arsimit, shëndetit, shërbimeve sociale, punësimit, drejtësisë, familjes, fëmijëve dhe të moshuarve, etj.

Me zbatimin efikas të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje Komuna Hanit të Elezit do të fuqizojë dhe rrisë efikasitetin e mekanizmave institucional për mbrojtje, parandalim, ndjekje penale dhe eliminim të dhunës në familje, vetëdijesimin e shoqërisë për të sfiduar sjelljet e dhunshme duke besuar dhe mbrojtur qëndrimin se dhuna në familje kundërshtohet anëtarë të saj është e pa-tolerueshme.

Dokumenti strategjik i referohet zbatimit të kuadrit ligjor kundër dhunës në familje në tërësi, i cili ndër të tjera thekson:

1. Të hartohen politika në nivel lokal për parandalimin, mbrojtjen dhe ofrimin e shërbimeve për viktimat dhe ushtruesit e dhunës në familje.
2. Mbështetja financiare e strehimoreve regjionale që mbështesin nëna me fëmijë, në proporcion me numrin e rasteve nga Komuna e Hanit të Elezit të strehuara si viktimat e dhunës në familje.

Përmbushja e obligimeve që rrjedhin nga strategjia do të kontribuojnë edhe në arritjen e synimeve nacionale të përcaktuara sipas Qëllimeve për Zhvillim të Qëndrueshëm në Kosovë (SDG), që bëjnë thirrje për eliminimin e pabarazive (SDG5)<sup>12</sup>, objektiv kjo që synon eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe vajzave, përfshirë trafikimin dhe format e tjera të shfrytëzimit si dhe eliminimin e të gjitha praktikave të dëmshme siç janë martesat e fëmijëve, martesat e hershme dhe të detyruara; si dhe promovimin e shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm (SDG 16)<sup>13</sup> objektiv kjo që synon përfundimin e

<sup>8</sup> OKB, Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, preambula 1948;

<sup>9</sup> Këshilli i Europës, Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, preambula, neni 4.2, 2011;

<sup>10</sup> Po aty, neni 4.3;

<sup>11</sup> Po aty, nenet 59-61, “kërkon që gratë viktimat e dhunës në familje, pavarësisht nga statusi ose vendbanimi i tyre, nuk do të kthehen në asnjë vend ku jeta e tyre do të ishte në rrezik ose ku ato mund t'i nënshtrohen torturës, apo trajtimit çnjerëzor ose degradues”.

<sup>12</sup> Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave;

<sup>13</sup> Paqe, drejtës dhe institucione të forta;

abuzimit, shfrytëzimit, trafikimit dhe të gjitha formave të dhunës ndaj dhe torturës ndaj fëmijëve dhe zvogëlimin e të gjitha formave të dhunës dhe vdekjeve të lidhura për të arritur një shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse.

Përmbushja e këtyre obligimeve dhe synimeve strategjike, do të mundësoj që Komuna Hanit të Elezit të shndërrohet në vend ku dhuna ndaj grave dhe në familje nuk tolerohet, reformimi i sistemit të mbrojtjes sociale të udhëheqet nga parimi i barazisë, si dhe të ndikohet në instalimin e filozofisë së inkurajimit të politikave sociale parandaluese, duke nxitur përparimin shoqërorë dhe qytetarisë demokratike në arritjen e vetëdijes më të lartë kolektive për barazi gjinore dhe të të drejtat e gruas të garantuar me konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, veçanërisht për Konventën e Këshillit të Europës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës Kundër Grave dhe Dhunës në Familje.

## II. Hyrje

Ndonëse, dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje është shkelje e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut<sup>14</sup> dhe përbën goditje të dinjitetit njerëzor, si në gjithë globin edhe në shoqërinë kosovare ajo vazhdon të jetë e përhapur me përmasa mjaftë të mëdha.

Dhuna ndaj grave është manifestim i marrëdhënieve historikisht të pabarabarta të pushtetit midis burrave dhe grave<sup>15</sup> dhe me të drejtë konsiderohet pengesa më madhe në realizimin e një bote paqësore, të prosperuar dhe të qëndrueshme. Krahas vështirësive ekonomike, shoqëria jonë po ballafaqohet edhe me një sërë problemesh tjera si: papunësia, lëvizjet demografike, ndryshime të koncepteve mbi vlerat dhe virtytet njerëzore, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në pjesëmarrjen e ulët të gruas në vendimmarrje dhe pabarazisë gjinore.

Duke qene se dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje gjithnjë e më shumë po njihet jo vetëm si shkelje e të drejtave individuale, por edhe si kërcënim për demokracinë, pengesë për zhvillim shoqëror dhe rrezik për paqe të qëndrueshme, pasojat e së cilës tronditin jo vetëm rrethim e ngushtë të familjes por të gjithë shoqërinë, dhe si e tillë kërkon angazhim të gjithë shoqërisë për marrjen e masave të nevojshme për parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje, misioni i OSCE në Kosovë mori iniciativën të përkrahë Mekanizmin Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në hartimin e Strategjisë Komunale dhe Planin e Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (2024- 2026).

Parasëgjithash, Strategjia do të ndikoj në rritjen e bashkëpunimit në mes të qytetarit dhe institucioneve shtetërore, shtyllat e së cilës janë të vendosura në “parandalimin e dhunës, mbrojtjen e viktimave të saj dhe ndjekja penale e dhunuesve”. Ajo synon gjithashtu të ndryshojë

---

<sup>14</sup>Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, 1994;  
<https://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/ViolenceAgainstWomen.aspx>, qasur më 1 korrik 2021;

<sup>15</sup>Këshilli i Europës, Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, preambula, 2011;

mendësitë e individëve duke iu bërë thirrje pjesëtarëve të shoqërisë, në veçanti burrave dhe djemve, të ndryshojnë sjellje.

Po ashtu, me anë të dokumentit strategjik synohet të vendoset një kornizë gjithëpërfshirëse dhe e unifikuar e përpjekjeve institucionale në kuadër të reformimit të sistemit për mbrojtjen nga dhuna në familje. Masa këto që i referohen fuqizimit të mekanizmave koordinues për reagim dhe bashkëpunim të shpejtë për parandalim dhe mbrojtje efikase të rasteve të dhunës në familje; promovimin e programeve dhe aktiviteteve për fuqizimin e grave, çrrënjosjen e paragjykimeve e stereotipeve si dhe pasojat e tyre; sigurimi i qëndrueshmërisë së shërbimeve për rehabilitim dhe riintegrim të viktimave të dhunës në familje.

Dokumenti strategjik identifikon çështjet që me prioritet kanë nevojë për ndërhyrje të menjëhershme duke kërkuar bërjen e përpjekjeve maksimale që të sigurohet “Një shoqëri që iu siguron të gjithë shtetaseve të saj, të rritur dhe fëmijë, të jetojnë pa frikë apo kërcënimin e dhunës në familje, që mbron viktimat, vendos kryerësit përpara përgjegjësisë dhe zvogëlon tolerancën e publikut ndaj veprimeve të dhunshme në familje”.<sup>16</sup>

Realizimi i të drejtave të njeriut, fillon me sigurimin e barazisë, rezultatet e të cilit janë të ndërlidhura në nivel të lartë të produktivitetit për ekonomin, gjendjen sociale dhe zhvillimin e vendit. Strategjia parashihet të jetë katalizatorë që duke përcaktuar hapat e mëtejshme që duhet ndërmerren drejt një strukture koherente për promovim, respektim, mbrojtje dhe luftim të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, të ndikojnë në përsheptimin e investimeve më të mira dhe të shtuara për të drejtat e njeriut për një barazi më të madhe dhe rritje ekonomike në vend. Për më tej, Strategjia në vete bënë edhe thirrje për aksion, që të bashkojmë dijet, energjinë, mundësit dhe financat, për realizim të plotë të të drejtave të njeriut, për të rritur mirëqenien dhe eliminimin e kohezionit social në Komunën e Hanit të Elezit.

### **III. Metodologjia**

Strategjia për Mbrojtje nga Dhuna në Familje është hartuar duke u bazuar në një metodologji të kombinuar në mënyrë që të jetë gjithëpërfshirëse, të adresojë prioritetet kyçe bazuar në nevojën për ndërhyrje dhe të siguroj që aktivitetet e përcaktuara do të kontribuojnë në arritjen e objektivave strategjike.

Në aspektin strukturor dhe përmbajtësor “Strategjia për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (2021-2025) është hartuar në përputhje të plotë me Udhëzimin Administrativ (QRK) nr. 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit, Rregulloren e Punës së Qeverisë Nr.09/2011 dhe Rregulloren (QRK) Nr.05/2016 për Standardet minimale për procesin e Konsultimit Publik.

---

<sup>16</sup>Ministria e Drejtësisë, Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Plani i Veprimit (2016-2020), 2016;



Hartimi i strategjisë është kryer përmes një procesi të gjatë pjesëmarrës, nën drejtimin e Komunës, drejtuesit më të lartë dhe stafet përgjegjëse të drejtorive të ndryshme përfshirë në proces, së bashku me të gjitha institucionet e tjera në nivel komunal. Janë organizuar një sërë takimesh të gjera për njohjen e situatës, hartimin e drejtimeve strategjike dhe planifikimin e aktiviteteve specifike sipas termave kohorë të kësaj strategjie.

Përgjatë procesit të hartimit të dokumentit strategjik janë organizuar punëtori me akterët relevantë në kuadër të Mekanizmit Komunal Koordinues Kundër Dhunës në Familje. Pjesëmarrës në punëtori ishin përfaqësues të: Policisë së Kosovës, Prokurorisë Themelore Ferizaj , Gjykatës Themelore dega në Kaçanik , Zyrës për Mbrojtje të Viktimave, Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, Drejtorisë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Drejtorisë Komunale për Arsim, Drejtorisë së Financave, Drejtorisë për zhvillim Ekonomik, Qendrës për Punë Sociale, Zyrës për Barazi Gjinore, Qendra e Mjekësisë Familjare, Strehimoreve dhe sipas nevojës janë realizuar takime individuale me aktorët kyç institucional dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile.

Veprime këto që kanë shërbyer të pranohen pikëpamjet dhe kontributet e të gjithë përfaqësuesve në kuadër të Mekanizmave Koordinues Kundër Dhunës në Familje dhe akterët tjerë relevantë, duke i vënë në pah përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet eventuale, në përmbushjen e objektivave të dokumentit strategjik. Po ashtu, punëtorja ka shërbyer si mjet për të pranuar pajtueshmërinë e të gjithëve në përcaktimin e qëllimit, objektivave, aktiviteteve, rezultateve dhe treguesve të dokumentit Strategjik.

Përgjithësisht, procesi i hartimit të strategjisë ishte i ndarë në tri faza:

# Faza e parë është karakterizuar me analizimin e situatës së përgjithshme, me ç'rast janë konsideruar dhe analizuar instrumentet dhe standardet ndërkombëtare, korniza ligjore vendore në fuqi, politikat dhe strategjitë për mbrojtje nga dhuna në familje, si dhe raporte, hulumtime e vlerësime të ndryshme, vendore e ndërkombëtare, të kryera së fundmi lidhur me fenomenin e dhunës në familje.

# Faza e dytë është karakterizuar me realizimin e punëtorive dhe sesioneve individuale me aktorët kyç institucional dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

# Ndërsa, në fazën e tretë dokumenti i është nënshtruar procesit të konsultimeve publike, duke u siguruar që procesi i hartimit të dokumentit strategjik është bërë i njohur dhe iu është dhënë mundësia për ofrimin e komenteve të gjithë akterëve institucional në nivel qendror dhe lokal, përfaqësuesve të OJQ, duke u siguruar që procesi i hartimit të dokumentit strategjik është bërë i njohur dhe iu është dhënë mundësia për ofrimin e komenteve të gjitha palëve të interesit, duke synuar pjesëmarrje gjithëpërfshirëse në procesin e parandalimit dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje në përputhje me interesin më të mirë të tyre.

Udhëheqësi i mekanizmit koordinues kundër dhunës në familje në bashkëpunim të ngushtë me anëtarët e mekanizmit nën përkrahjen e Misionit të OSCE në Kosovë, ka shqyrtuar, inkorporuar dhe validuar inputet e pranuar nga procesi i konsultimit publik dhe sipas legjislacionit në fuqi, dokumenti strategjikë është proceduar për aprovim në Kuvendin Komunal.

## **IV. Sfondi**

### **4.1 Analiza e përgjithshme e situatës së dhunës në familje**

Barazia gjinore është një parim i të drejtave të njeriut, andaj të drejtat e grave janë pjesë e patjetërsueshme, integrale dhe e pandashme e të drejtave universale të njeriut. Një jetë e lirë nga dhuna është një parakusht dhe një kërkesë themelore për një jetë të barabartë. Kur flasim për “mbrojtjen nga dhunën në familje”, Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me institucionet qeveritare në nivel qendror dhe lokal, veçanërisht Agjencinë për Barazi Gjinore, me përkrahjen e organizatave vendore e ndërkombëtare, si misioni i OSBE në Kosovë, ka arritë të zhvillojë nisma reformuese dhe avancime pozitive në kontekst të zbatimit praktik të kuadrit ligjorë duke adresuar standardet ndërkombëtare<sup>17</sup>.

Reforma këto që kanë ndikuar në zhvillimin e vullnetit politik dhe angazhimit institucional në përfshirjen e “barazisë gjinore” në qendër të politikave strategjike që ka rezultuar me hartimin e politikave dhe legjislacionit vendorë në përputhje me standardet ndërkombëtare, hartimin e programeve specifike për mbrojtje nga dhuna në familje dhe për barazi gjinore, marrjen e masave që synojnë të përmbushin nevojat specifike të grave dhe zhdukjen e zakoneve/praktikave që rezultojnë negativisht në gëzimin e plotë të të drejtave të njeriut.

Mirëpo, përfshirja e këtyre standardeve në agjendën e politikave institucionale nënkupton jo vetëm zotim për realizim të tyre, por marrjen e një sërë masash për përmbushjen e një numri të caktuar të kërkesave që duhet të shihen si tregues cilësorë të vullnetit politik për të arritur në thelb barazinë gjinore, për rrjedhojë edhe mbrojtjen nga dhuna në familje.

Bazuar në të gjeturat raporteve të monitorimit për mbrojtjen nga dhuna në familje, që njëherit pasqyrojnë situatën aktuale sa i përket barazisë gjinore në Republikën Kosovë duke ofruar informata mbi treguesit kyç të cilët janë në përputhje me kriteret e përcaktuara në legjislacionit vendor, Konventën e Këshillit të Europë për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje dhe Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm (të njohur si SDG), rezultojë se janë bërë përmirësime të ndjeshme duke evidentuar arritjet më të rëndësishme, përfshirë: zvogëlimin e qëndrimeve paragjyquese dhe sjelljeve që e mbështesin dhunën në

---

<sup>17</sup> Standardet e përcaktuara në “Rekomandim i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës CM/Rec (2007)/17 Rekomandim për standardet dhe mekanizmat e barazisë gjinore”;

familje; themelimin e mekanizmave koordinues në nivel qendror dhe lokal kundër dhunës në familje; rritjen e njohurive në mesin e profesionistëve që direkt ose indirekt punojnë për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje; lehtësimi i qasjes në shërbime dhe rritja e efikasitetit të tyre, për rehabilitim dhe riintegrim të viktimave të dhunës në familje. Të arritura këto, të cilat janë në hap me agjendën dhe përpjekjet globale për mbrojtjen nga dhuna në familje.

Megjithatë, mbetet ende shumë për t'u bërë për të përmirësuar përpjekjet e bashkërenduara institucionale në fuqizimin e mekanizmave për reagim të shpejtë, mbrojtje dhe trajtim të rasteve të dhunës në familje; për të siguruar mirëqenien e viktimave të dhunës në familje; rehabilituar dhe riintegruar viktimave të dhunës në familje duke ju siguruar mundësi të jetojnë të barabartë dhe me dinjitet; nxitjen e përparimit shoqëror duke mos e toleruar dhe justifikuar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje; dhe vënien përpara përgjegjësisë, njëkohësishtë rehabilitimin e vazhdueshëm të kryesve të dhunës në familje.

Dhuna me bazë gjinore është shkelja më e rëndë nga shkeljet me të cilat përballen shumë gra dhe vajza. Pabarazia gjinore dhe dhuna ndaj grave janë ngushtë të ndërlidhura me njëra-tjetrën. Parandalimi i dhunës me bazë gjinore shpesh mbizotëron diskursin për pabarazinë gjinore, posaçërisht në shoqëritë më patriarkale, siç është Kosova. Vlerësohet se të paktën 12 gra vriten nga dhuna e lidhur me gjininë në Evropë çdo ditë. Ndërsa, në Kosovë një në çdo tre gra ka përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partneri<sup>18</sup>.

Mbizotërimi i dhunës me bazë gjinore mbetet alarmant në Kosovë. Gjatë dhjetëvjeçarit të kaluar, ka pasur një rritje në numrin e raportuar të rasteve të vrasjeve që kanë rezultuar nga dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore. Derisa mesatarja vjetore e rasteve të raportuara ndërmjet viteve 2002 dhe 2017 ishte 1.152, vetëm në vitin 2019 u raportuan 1.915. Përkundër rritjes së numrit të rasteve të raportuara të dhunës në familje, bazuar në përfundimet e sondazheve konkludohet se incidentet aktuale janë shumë më të larta, deri në 68% dhe se shumë raste mbeten të pa raportuara. Gjatë viti 2020 dhe veçanërisht gjatë kohës së masave të bllokadës për shkak të parandalimit të përhapjes së virusit COVID-19, sipas të dhënave të Policisë së Kosovës gjatë vitit 2020 janë raportuar, pothuajse, 650 raste të dhunës në familje në të gjithë vendin: 161 raste të raportuara në muajin janar, 151 në muajin shkurt, 169 në muajin mars dhe 167 në muajin prill.<sup>19</sup>

Ndërsa, reagimi i institucional për marrjen e masave të nevojshme dhe efektive për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe me bazë gjinore, rezultonë të jetë i dobët. Këtë e dëshmon edhe norma lartë e rasteve të hedhura poshtë të dhunës në familje, pasi gjatë vitit 2017 ishin më shumë se gjysma e të gjitha kallëzimeve penale të lidhura me rastet e dhunës në familje (51.5%) që ishin hedhur poshtë nga gjykatat e Kosovës. Për më tepër, gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2018, u

<sup>18</sup>UN Women, "Fakte dhe Shifra: Përfundimi i dhunës kundër grave një pandemi në formate ndryshme", faqja e qasur më 22.7.2018. at: [/www.unwomen.org/en/ëhat-ëe-do/ending-violence-against-ëomen/facts-and-figures](http://www.unwomen.org/en/ëhat-ëe-do/ending-violence-against-ëomen/facts-and-figures);

<sup>19</sup><https://balkaninsight.com/> COVID-19 dhe dhuna në familje: Kur shtëpia s'është vendi më i sigurt, prill, 2020;



hodhën poshtë gjithsej 15.1% raste. Për periudhën e monitoruar për 2015-2018, vetëm 40.4% e rasteve kanë marrë vendime të fajësisë. Kjo përgjigje e ngadaltë nga sistemi i drejtësisë penale ndaj rasteve të dhunës në familje ka çuar në shfaqjen e përgjithshme të mosndëshkimit për autorët e dhunës në familje. Për më tepër, viktimat që fajësohet dhe pajtimi i viktimës me kryerësin mbetet e zakonshme në mesin e të gjitha institucioneve të monitoruara, shpesh të justifikuara me qëllim të "shpëtimit" të familjes tradicionale<sup>20</sup>. Për më tej, studimet vinë në përfundim se: gati një e treta e kosovarëve besojnë se në familje "dhuna është pjesë normale e çdo marrëdhënieje dhe shoqëria në përgjithësi pranon se dhuna mund të ndodhë ndonjëherë". Për më keq, një në tre kosovarë beson se dhuna në familje është "problem familjar, kështu që fqinjët nuk duhet ta raportojnë atë në polici"<sup>21</sup>.

#### **4.2 Analiza e situatës së dhunës në familje në Komunën e Hanit të Elezit.**

Dhuna në Familje nuk është një dukuri e re për qytetarët e komunës sonë, por edhe shoqërinë kosovare në përgjithësi. E shprehur në forma dhe intensitete të ndryshme ajo është trashëguar prej së shkuarës, por në ditët e sotme vërehen edhe shumë tipare të reja të shprehjes së saj. Analiza e shkurtër e situatës në Komunën e Hanit të Elezit ka ndihmuar të qartësohet lista e problemeve dhe shkaqeve që i shkaktojnë ato. Shkaqet që çojnë në rritjen e shkallës së Dhunës në Familje janë të shumta, ndërmjet të cilave përmendim:

**Pabarazitë gjinore:** Në Kosovë, roli i femrave në proceset e zhvillimit shoqëror, ekonomik dhe politik është shumë i rëndësishëm, ndonëse ende në ditët e sotme ndeshemi me pabarazi gjinore të dukshme apo të fshehura. Pozita e pabarabartë gjinore ndikohet nga shkalla e ulët e punësimit të grave, vështirësitë që kanë në qasje të shërbimeve shëndetësore, niveli i ulët i integritetit të grave në ekonomi dhe numri i vogël i grave në pozitat udhëheqëse në administratën publike.

Në Kosovë është krijuar një bazë e mirë ligjore sa i përket çështjes së barazisë gjinore dhe janë bërë hapa të dukshëm në avancimin e pozitës së grave, ku Komuna e Hanit të Elezit krahas viteve të mëhershme, ka shënuar progres të dukshëm në avancimin e gruas. Të dhënat paraqesin një përfshirje më të madhe të grave në politikë, në arsim, e sektorë të tjerë. Megjithatë, ende nuk është arritur përfaqësimi i kënaqshëm gjinor, i paraparë në Ligjin për Barazi Gjinore, në të cilin përcaktohet se pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe meshkujve, në institucione apo në nivel të pushtetit.

Duke pasur parasysh trendet e shkallës së papunësisë, për një pjesë të popullsisë në Komunën e Hanit të Elezit, femra mbetet në pozitë më të pafavorshme krahasuar me meshkujt si në lëmin e punësimit, nivelit të varfërisë, arsimit, si dhe pjesëmarrjen aktive në sferën publike dhe private.

<sup>20</sup>KIPRED, Qasja në drejtësi e viktimave të dhunës me bazë gjinore në Kosovë: Përfundimi i mosndëshkimit të autorëve të krimit, 2018;

<sup>21</sup>Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovë, Mjaft më me arsytimit: Analiza e qëndrimeve, incidencës dhe reagimeve institucionale ndaj dhunës në familje në Kosovë, 2015;

## **Raste të dhunës në familje për 3 vite në komunën tonë pra raste të cilat janë lajmëruar sepse shifrat janë edhe më të mëdha**

2020: 3 raste të dhunës në familje

2021: 3 raste të dhunës në familje

2022: 4 raste të dhunës në familje

### **4.3. Pasojat më të theksuara të dhunës në familje**

Dhuna në Familje sjell shumë pasoja në komunitet, të cilat kanë një numër të madh efektesh të padëshiruara:

**Kriza familjare:** Avancimi i rolit të femrës në shoqëri dhe pozita e saj në familje ka ndryshuar në kuptimin e pavarësisimit më të madh të saj, marrjes së iniciativave, edukimit dhe arsimimit, fakte të cilat kanë ndikuar në ndryshimin e roleve në familje dhe shoqëri. Kriza familjare në periudhën e pas luftës në Kosovë ka shkaqe të ndryshme: lëvizja e popullatës nga fshatrat në qytete, kalimi nga familjet e zgjeruara dhe të mëdha në familje më të vogla. Të tilla ndryshime shihen si faktorë mbrojtës (kur shmanget ndikimi patriarkal prej brezave më të vjetër), por edhe faktorë rreziku njëherësh, si pamundësia e mbrojtjes në rastet e dhunës në familje të nxitura nga papunësia, konfliktet dhe mentalitetit mes gjeneratave, etj.

**Frika dhe ndërgjegjësimi ulët për çështjet e dhunës në familje:** Mos raportimi i dhunës në familje nga viktimat është ndër fenomenet më të shpeshta, pasi konsiderohet turp dhe një çështje që nuk duhet të dalë jashtë mureve të shtëpisë.

**Mospranimi i dhunës seksuale:** Për shkak të stigmës dhe ndëshkimit vërehet mos raportim i dhunës nga ana e viktimave dhe për këtë dhuna seksuale rezulton më pak e raportuar ose nuk ekziston fare në krahasim me dhunën fizike.

**Probleme lidhur me trashëgiminë:** Sa i përket procedurave të shqyrtimit të trashëgimisë, shumë herë ndodh që gruaja nuk njoftohet fare ose përjashtohet nga diskutimi për masën trashëgimore, qoftë në pozitën e bashkëshortes, nënës apo motrës dhe në këtë mënyrë diskriminohet. Veç kësaj, organi kompetent komunal për mbajtjen e librit amzë të vdekjeve ka për detyrë që në aktvdekje të shënojë emrat e trashëgimtarëve femra dhe meshkuj dhe asesi të mos i diskriminojë femrat

## V. Objektivat strategjike

“Dhuna ndaj grave në thelb është çështje e pushtetit. Ajo do të përfundojë vetëm kur barazia gjinore dhe fuqizimi i plotë i grave do të behën realitet.” (Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, António Guterres)

Objektivat strategjike kanë pikë synim të kontribuojnë në arritjen e barazisë duke punuar në parandalimin e dhunës në familje, sepse një jetë e lirë nga dhuna është një parakusht dhe një kërkesë themelore për një jetë të barabartë.

Po ashtu, të rrisin ndikimin dhe dukshmërinë e standardeve ndërkombëtare dhe zbatimin e kornizës ligjore kombëtare për mbrojtjen nga dhuna dhe promovimin e barazisë gjinore, duke mbështetur zbatimin e tyre përmes një sërë masash që promovojnë ndryshimin në modelet shoqërore dhe kulturore të sjelljes së gra dhe burra.

Të sigurojë që vajzat trajtohen me respekt të plotë për dinjitetin dhe të drejtat e tyre duke promovuar mjedis pa dhunë në Komunën e Hanit të Elezit . Për të siguruar që profesionistët që ofrojnë shërbime themelore për mbrojtje të viktimave të dhunës në familje, kanë njohuritë e nevojshme për të integruar një perspektivë gjinore në politikat publike, si dhe marrjen e masave të nevojshme për parandalimin e dhunës në familje.

Strategjia komunale kundër Dhunës në Familje për Komunën e Hanit të Elezit synon të:

- Të punojë në parandalimin e dhunës në familje dhe ngritjen e vetëdijes tek komuniteti për aspektet negative të këtij fenomeni;
- Të përmirësojë/ndërtojë sistemin e grumbullimit dhe shkëmbimit të të dhënave në mes të akterëve relevant;
- Të fuqizojë mekanizmat për reagim sa më të shpejtë ndaj rasteve të dhunës në familje dhe të përmirësojë koordinimin në mes anëtarëve të grupit gjatë menaxhimit të tyre;
- Të bëjë avokim dhe monitorim të zbatimit të politikave si dhe të sugjerojë ndryshime bazuar në përvojat më të mira nga terreni.

Mbështetur në tri fusha të veprimit, si **“Vetëdijësimi dhe Parandalimi”**; **“Mbrojtja dhe Koordinimi”**; **“Fuqizimi ekonomik, rehabilitimi dhe riintegrimi”** me anë të adresimit të objektivave strategjike dhe specifike, si:



**Objektiva Strategjike #1:** Përmirësimi i sistemit institucional për parandalim dhe ofrim të shërbimeve cilësore për mbrojtje nga dhuna në familje:

**Objektiva specifike #1.1:** Ngritja e kapaciteteve të profesionistëve për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje;

**Objektiva specifike #1.2:** Vetëdijësimi i opinionit publik për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;

**Objektiva specifike #1.3:** Inkurajimi i qytetarëve dhe viktimave të dhunës në familje për raportimin e rasteve të dhunës në familje;

**Objektiva Strategjike # 2:** Përmirësimi i qeverisjes lokale për parandalimin dhe mbrojtje nga dhuna në familje:

**Objektiva specifike # 2.1:** Funkcionalizimi i Mekanizmit Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje;

**Objektiva specifike # 2.2:** Fuqizimi i sistemit të raportimit dhe ankesave për mbrojtje nga dhuna në familje;

**Objektiva specifike # 2.3:** Avancimi i monitorimi të politikave dhe obligimeve ligjore për mbrojtje nga dhuna në familje;

**Objektiva specifike # 2.4:** Fuqizimi ekonomik i grave dhe viktimave të dhunës në Familje;

**Objektiva Strategjike # 3:** Fuqizimi i shërbimeve rehabilituese dhe riintegruese të viktimave të dhunës në familje:

**Objektiva specifike # 3.1:** Avancimi i shërbimeve rehabilituese për mbrojtje nga dhuna në familje;

**Objektiva specifike #3.1:** Avancimi i shërbimeve riintegruese për mbrojtje nga dhuna në Familje;

## **VI.Plani i Veprimit**

<b>FUSHA E VEPRIMIT – A. ELIMINIMI I PABARAZIVE GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE</b>					
<b>Deri në vitin 2026, strategjia lokale synon të ndryshojëqasjen në familje dhe shoqëri për eliminimin e pabarazisë gjinore dhe dhunën në familje</b>					
<b>Drejtimi strategjik</b>	<b>Aktivitetet</b>	<b>K Koha e zbatimit Sipas shtyllave: <u>P</u>arandalim, <u>M</u>brojtje, <u>R</u>iintegrim Sipas kohës së zbatimit: <b>ASH</b> – Afatshkurtër, <b>AM</b> – AfatMesëm; <b>AGJ</b> –Afat Gjatë</b>	<b>Indikatori i suksesit</b>	<b>Institucion përgjegjës për zbatim</b>	<b>Kostoja buxhetore</b>
A.1. Eleminimi i stereotipeve gjinore për luftimin e dhunës në familje	1.1 Fushata vetëdijësuese dhe kampanja informuese, vebfaqja komunës, rrrjetet sociale, për publikun e gjerë në komunën e Hanit të Elezit	P+M+R  ASH+AM	Prej rreth 10.000 banorëve , rreth 50% e tyre ta marrin mesazhin si dhe të jen bërë pjesë e aktiviteteve ndërgjegjësuese	QPS PK ZBGJ Komuna DKA OJQ-te QKMF KBI Zyra per ndihm juridike falas	300 €
	1.2 Trajnimet për Barazi gjinore dhe dhunën në familje me përfaqësues të instucioneve vendore	P+M+R  ASH+AM			200 €
A.2. Ngritja e vetëdijësimit të grave dhe të rinjve, institucioneve dhe bizneseve për pasojat e dhunës në familje dhe të pabarazisë gjinore.	2.1 Fushata (drama, me temë të barazisë gjinore dhe dhunës në familje, ligjërata, ese, dhe piktura) me të rinjtë;	P  Aktivitet në vijimësi	Rritja e përqindjes së grave dhe vajzave të ndërgjegjësuar nga 20% në 40%	Komuna ZBGJ DKA Policia OJQ Donatorë QKMF KBI	300 €
	2.2 Takime me gra dhe vajza në fshatra për të drejtat e tyre ligjore, me fokus në DHF, dhe lajmërimi i rasteve të DHF, gjatë takimeve do të shpërndahen informacione dhe fletëpalosje	P  Aktivitet në vijimësi			200 €

A.3 Hulumtimi dhe mbledhja e të dhënave dhe statistikave të dhunës në familje, në Komunën tonë.			Mbshteja instucionale e mekanizmit Hulumtimi , ruajtja e te dhenave,	Komuna MKDHF OJQ QKMF Donatorë	
	Takimete e rregullta të mekanizmit kundër dhunës në familje dhe diskutimi i rasteve Krijimi i një databaze ndërinstitucional – mekanizmi	P+M+R AGJ  AGJ			300 €
A.4. Fuqizimi i rolit te gruas në shoqëri përmes promovimit dhe rritjes së numrit të femrave në pozicionet vendimmarrëse	3.1 Ndarja e përvojave tësuksesshme të modeleve në takime me gratë dhe komunitetin	P  AGJ	Rritja e përqindjes së grave pjesëmarrëse aktive në takime  Rritja e përqindjes së grave në pozicionet vendimmarrëse nga 30% në 45%	Komuna ZBGH OJQ lokale Grupi i grave asambleiste	200 €



**FUSHA E VEPRIMIT – B. ARSIMIMI DHE INFORMIMI**

**Deri në vitin 2026, strategjia lokale synon një komunitet të mirë informuar , edukuar në çështjet e dhunës në familje , me profesionistë të përgatitur për të parandaluar, njohur dhe kualifikuar për trajtimin adekuat të viktimave të dhunës në familje dhe të komunitetit në tërësi si dhe të kryerësve të veprave penale**

Drejtimi strategjik	Aktivitete	Lidhja me Strategjinë Kombëtare dhe Koha e zbatimit Sipas shtyllave: <u>Parandalim</u> , <u>Mbrojtje</u> , <u>Riintegrim</u> Sipas kohës së zbatimit: <u>ASH – Afatshkurtër</u> , <u>AM – AfatMesëm</u> ; <u>AGJ – Afat Gjatë</u>	Indikatori I suksesit	Institucioni përgjegjës për zbatim	Kostoja buxhetore
B.1 Ndërgjegjësimi i nxënësve dhe prindërve të AMU dhe AML për çështjet e dhunës në familje	1.1 Aktivitete informuese nëpërmjet mekanizmit kordinues, në kuadër të orëve mësimore dhe të fletëpalosjeve, broshurave, etj	P+M+R  Aktivitet në vijimësi	Deri në vitin 2026, rreth 50% e nxënësve dhe prindërve janë të ndërgjegjësuar për LMDF dhe DHF	Mekanizmi kordinues QPS ZBGJ Drejtoria e arsimit, QKMF, OJQ – të PK KBI	300 €
	1.2 Informimi i qytetarëve përmes ueb faqes se komunes, rrjeteve sociale	P  Aktivitet në vijimësi			
	1.3 Aktivitete informuese dhe edukuese në kuadër të programit të aktiviteteve shkollore me pjesëmarrjen e nxënësve (orë mësimore, fushata, postera)	P  ASH + AM			

B.2 Ngritja profesionale e mësimit të edukatës qytetare lidhur me DHF dhe trajtimin e saj	2.1 mbajtja e ligjëratave në orën mësimore me temën dhuna në familje, dukurit negative në shoqëri nga mësuesit e edukatës qytetare.	P Aktivitet në vijimësi	Deri në vitin 2026, 15% e orëve të edukatës qytetare do të kalojnë në tematikë të DHF	Drejtoria e Arsimit ZBGJ Komuna OJQ	150 €
	2.2 Organizimi i vizitave studimore për shkëmbimin e përvojave me vendet e rajonit dhe komunave	P AM			Donatorët
B.3 Ulja e numrit të nxënësve që braktisin shkollën e ulët dhe të lartë si rezultat i DHF, në zonat rurale.	3.1 Kryerja e hulumtimeve sociologjike mbi shkaqet kryesore të braktisjes së shkollës prej nxënësve të familjeve ku ushtrohet dhunë	P+M+R ASH	Deri në vitin 2026, ulet numri i nxënësve që braktisin shkollën prej DHF	Drejtoria e Arsimit Mekanizmi kordinues	
	3.2 Monitorimi i aplikimit të masave ligjore që sanksionojnë braktisjen e shkollës	P+M ASH+AM			

## FUSHA E VEPRIMIT – C. FUQIZIMI I BAZËS EKONOMIKE

Deri në vitin 2026, strategjia lokale synon në parandalimin, mbrojtjen dhe rintegrimin përmes mbështetjes ekonomike dhe dhënien e mundësive për mirëqënien e të mbijetuarave të DHF dhe të familjeve të tyre si dhe kryerësve të veprës penale

Drejtimi strategjik	Aktivitete	Lidhja me Strategjinë Kombëtare dhe Koha e zbatimit Sipas shtyllave: <u>P</u> arandalim, <u>M</u> brojtje, <u>R</u> iintegrim Sipas kohës së zbatimit: ASH – Afatshkurtër, AM – AfatMesëm; AGJ – Afat Gjatë	Indikatori I suksesit	Institucioni përgjegjës për zbatim	Kostoja buxhetore
C.1 Fuqizimi ekonomik i viktimave të dhunës në familje në përkrahjen për punësim dhe vetëpunësim	1.1 Rregjistrimi, evidentimi dhe orientimi i viktimave të DHF pranë komunës dhe zyrës së punësimit	M+R  AM	Brenda 3 viteve sistemi i rregjistrimit dhe orientimit bëhet funksional sipas standardeve kombëtare në përpunim	Komuna QPS ZPK Sipas përcaktimit të standartit kombëtar	
	1.2 Ofrimi i këshillave në prezantimin e dokumentacionit për aplikim të suksesshëm sipas tregut të punës	M+R  Aktivitet në vijimësi			
	1.3 Hartimi dhe aproviminormaverregullative, përmes krijimit të politikave, për lirimin nga taksat komunale në rastet e hapjes së një biznesi të ri	M+R  ASH			

C.2. Mbështetje socio ekonomike të mbijetuarave të DHF si dhe strehimi i tyre	2.1 Ofrimi i trajnimeve për ngritjen profesionale, informacioneve për mundësitë për biznes	M+R Aktivitet në vijimësi	40% e viktimave përfitojnë nga shërbimet në këtë kategori	Komuna ZPK	
	2.2 Ofrimin e mbështetjes ekonomike me fond të veçantë prej komunës	M+R AM			
	2.3 Ndarja e subvencioneve për familjet në zonën rurale	P+M+R AM			
	2.4 Përkrahje e strehimores “Shtëpia ime ” për kryerjen e shërbimeve dhe mbështetjen e të mbijetuarave të DHF	M+R Aktivitet në vijimësi			500 €
C.3. Zgjidhje afatmesme e strehimit për rastet e të mbijetuarave të DHF	3.1 Pagesa e qirasë për vendëstrehimin e viktimave të dhunës në familje	M+R Aktivitet në vijimësi		Komuna Donatorë	
C.4 Trajtimi i viktimave të dhunës në familje Mbështetja mjekesore dhe psikologjike e të mbijetuarve të dhunës në familje .	1.Trajtimi me prioritet dhe privatesi të plotë (përpos rasteve emergjente) 2. Furnizimi me protokole dhe udhërrëfyes të trajtimit të dhunës në familjedhe furnizimi me medikamente të cilat mungojne nga lista esenciale falas ,mbështetja psikologjike e tyre				QKMF



## **VII. Aranzhimet e zbatimit, monitorimit dhe raportimit**

### **7.1. Shtrirja kohore e strategjisë**

Synimi kryesorë i Komunës së Hanit të Elezit, pa dyshim se është zbatimi në tërësi i dokumentit strategjikë, proces ky që do të përcaktohet nga realizimi i aktiviteteve dhe objektivave të përcaktuara në Planin e Veprimit nëpër vite. Procesi i zbatimit të strategjisë, do të jetë një proces i realizimit të synimeve strategjike dhe objektivave të saj.

Procesi i zbatimit të masave dhe politikave të parashikuara në Strategjinë Komunale kundër Dhunës në Familje kanë një shtrirje të kohë gjatësisë prej 5 viteve, që përfshin vitet 2021-2025. Ndërsa, për zbatimin e objektivave strategjike, hartohet Plani i Veprimit 3 vjeçarë në të cilat përcaktohen objektivat specifike, aktivitetet konkrete karshi institucioneve përgjegjëse dhe mbështetëse për zbatimin e tyre, treguesit SMART, gjendja ekzistuese, synimi/targeti, burimet financiare, të cilat duhet përlllogaritur duke iu referuar buxhetit të paraparë në kornizën/grandin komunal si dhe afatet kohore për përmbushjen e tyre. Gjithashtu, në përlllogaritjen e nevojave financiare duhet të merren në konsideratë edhe projektet me financim nga donatorët, në vijim ose të planifikuara, sipas fushave specifike.

Zyrtari/ja për Barazi Gjinore do të jetë përgjegjëse për koordinimin dhe bashkërendimin e punës përgjatë hartimit të Planit të Veprimit në bashkëpunim me të gjithë akterët relevantë. Obligohen të gjitha institucionet mandatore në nivel lokal, për zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve të përcaktuara në Strategjinë dhe Planin e Veprimit kundër Dhunës në Familje. Po ashtu, institucionet përgjegjëse, departamentet komunale përkatëse, duhet të sigurojnë përfshirjen e politikave, aktiviteteve që burojnë nga strategjia në kuadër të planeve vjetore të punës së tyre.

Përderisa, monitorimi dhe vlerësimi i realizimit të objektivave dhe efektshmërisë së aktiviteteve përkatëse, janë pjesë integrale e strategjisë dhe komponentë kryesor e procesit të zbatimit të saj. Monitorimi dhe vlerësimi do të shërbejnë për të ndjekur ecurinë e strategjisë, për të matur në proces shkallën e realizimit të objektivave të saj, për të vlerësuar nevojën dhe përcaktuar drejtimit e rregullimeve, veçanërisht lidhur me aktivitetet. Procesi i monitorimit do të realizohet nga Mekanizmit Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në bashkëpunim me institucionet lokale përgjegjëse për zbatim të dokumentit strategjikë dhe me pjesëmarrjen e gjerë të organizatave jo qeveritare, strehimoreve dhe grupeve tjera të interesit.

Andaj, çdo fund vit, Zyrtari/ja për Barazi Gjinore në bashkëpunim me Mekanizmin Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, do të hartojnë raportin vjetor i cili duhet të përmbajë vlerësimin e aktiviteteve më të suksesshme dhe në përgjithësi përmbushjen e qëllimeve të strategjisë, identifikimin e sfidave dhe vështirësive të hasura gjatë procesit të zbatimit si dhe ofrimin e rekomandimeve konkrete për mënjanimin e pengesave të paraqitura përgjatë procesit të përmbushjes së objektivave specifike dhe atyre strategjike. Për monitorimin e zbatimit të dokumentit strategjikë dhe efektivitetit të saj janë esenciale:

- (i) për të siguruar që po arrihen qëllimet,
- (ii) për të monitoruar kontributet e investuara dhe aktivitetet,
- (iii) për të siguruar nëse implementimi po shkon sipas rrjedhës së përcaktuar,
- (iv) për të paralajmëruar institucionet përgjegjëse për problemet/ngeçjet ose problemet potenciale para se situata të bëhet kritike,
- (v) për të sugjeruar veprime korigjuese ose për të rishikuar strategjinë në bazë të përvojës së fituar.

Duke monitoruar strategjinë dhe indikatorët e performancës, Komuna e Hanit të Elezit do të jetë në gjendje të krijojë një pasqyrë mbi gjendjen, d.m.th. në ç ‘ pikë ndodhet strategjia drejt arritjes së qëllimeve të përcaktuara, nxjerrjes së mësimëve, marrjes së masave korigjuese, dhe, nëse është e mundur, proceseve rishqyrtuese të saj

## 7.2. Mekanizmat zbatues

Të gjitha institucionet qeveritare lokale, obligohen të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për zbatimin të detyrimeve të përcaktuara në “Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje” nëpër vite, në përputhje me përgjegjësitë dhe mandatin ligjor të tyre.

Institucioni kryesor përgjegjës për zbatim të strategjisë është Komuna e Hanit të Elezit me dikasterët e saj (ZBGJ, QPS, QKMF, DKA ), Policia e Kosovës, Prokuroria dhe Gjykatat Kshilli i Bashkësis Islame .

Ndërsa si institucione që mund të i ndihmojnë në parandalimin e dhunës në familje, dhe mbrojtjen e viktimave, janë: Ekipa Vepruese për Siguri në Bashkësi – EVSB, Këshilli i Veprimit Rinor Lokal, OJQ-të.

**Zyra për Punësim:** Në koordinim me Qendrën për Punë Sociale, regjistron dhe evidenton personat, të cilët lajmërohen në zyrë, ndaj të cilëve është ushtruar dhunë në familje. Këtyre personave në cilësi të punëkërkesve, ju ofrohet: këshillim profesional, informim mbi mundësitë e punësimit, përgatitje dhe ndërmjetësim në punësim, informim për aftësim dhe riaftësim profesional me qëllim përgatitjen për nevojat e tregut të punës.

**Mbrojtësi i viktimave** i cili bashkëpunon ngushtë me institucionet e tjera që ofrojnë ndihmë për viktimat e Dhunës në Familje, dhe lloje të tjera të dhunës apo trafikimit me qenieve njerëzore, etj si Policinë, QPS, Prokurorinë, Gjykatën, QKMF, strehimoren, etj. Ndër detyrat e tij është të informojë viktimën për të drejtat ligjore, të parapara sipas ligjeve në fuqi për dhunën në familje, të parapërgatitë viktimën për seancat gjyqësore, e shoqëron gjatë seancave si në Prokurori dhe Gjykatë, etj.

**Zyra për Ndhimë Juridike falas:** Kjo zyrë është në objektin e QPS-së në katin e parë, e cila gjendet në Han të Elezit dhe ofron ndihmë juridike falas edhe për viktimat e dhunës dhe është e hapur dy ditë në javë.

## **7.2. Mekanizmat monitorues dhe raportues**

Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit, do të shtrihet në të gjitha institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse për realizimin e objektivave të përcaktuara në Strategji si dhe aktiviteteve që do të përcaktohen në Plan të Veprimit.

Për ta vlerësuar cilësinë dhe efektivitetin e ndërhyrjeve, apo anasjelltas, Mekanizmi Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje do të raportojnë përparimin në jetësimin e zbatimit të dokumentit strategjikë në baza vjetore.

ZBGJ (të përcaktohetkush sipas specifikave të Komunës) do të ketë rolin udhëheqës për të bashkërenduar punën, mbikëqyrur dhe vlerësuar procesin e zbatimit të Planit të Veprimit, në të njëjtën kohë do të shërbejë si Sekretariat, dhe në baza periodike çdo vit/6 muja do t'i raportojë direkt Kryetarit të Komunës. Me ç 'rast, çdo fund vit Mekanizmi Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje është i obliguar të hartojnë "Raportin e Monitorimit" mbi zbatimin e dokumentit strategjikë, i cili do të jetë treguesi kyç për të pasqyruar qartë progresin apo regresin mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe aktiviteteve të parapara në Planin e Veprimit. Ndërsa, varësisht nga rekomandimet e dala nga "Raporti i Progresit", institucionet përgjegjëse janë të obliguara ti shqyrtojnë dhe të zbatojnë ato në bazë sa më optimale të mundshme.

Njëkohësisht, institucionet qeveritare në nivel lokal, do të raportojnë në bazë të nevojave dhe kërkesës të drejtuar nga ZBGJ (te përcaktohet kush sipas specifikavete Komunës), në mënyrë që raportet institucionale të jenë të unifikuara dhe gjithëpërfshirëse.

Organizatat jo-qeveritare, inkurajohen që në partneritet me institucionet qeveritare të marrin pjesë në zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e dokumentit strategjikë.

Në çdo nismë të realizuar nga institucionet shtetërore, shoqëria civile dhe OJQ-të do të inkurajohen të paraqesin edhe raportet e tyre vëzhguese mbi zbatueshmërinë e dokumentit strategjikë apo raportet e tyre mbi aktivitetet e realizuara që lidhen me projektet dhe programet për realizimin e të drejtave të fëmijëve.

**Koordinator i mekanizmit kundër dhunës në familje**

**Amir Bushi**



---

**PLANI I PUNËS**  
**PËR**  
**EKIPIN KOMUNAL PËR TË DREJTAT E FËMIJËS, HANI I ELEZIT**  
**(2024– 2026)**

**Hani i Elezit, Tetor 2023**



## HYRJE

Komuna e Hanit të Elezit i kushton rëndësi mirëqenies së të gjithë qytetarëve të saj. Me politikat dhe praktikën e saja, qeverisja komunale siguron shërbime cilësore për qytetarët, pavarësisht përkatësisë së tyre mbi çfarëdo baze. Sidoqoftë, fëmijët janë një grup i qytetarëve tanë që konsiderohen si kategori e veçantë dhe në nevojë në vështrim të gëzimit të të drejtave të tyre të njeriut. Për shkak të moshës së tyre, ata ende nuk e kanë zhvillimin e plotë fizik, kognitiv e emocional. Prandaj varen nga të rriturit në gëzimin e të drejtave të tyre. Si Komunë ne jemi të përcaktuar të vihem në mbrojtje të të drejtave të tyre dhe në ofrimin e kushteve për zhvillim të plotë të tyre. Ky përcaktim, reflektohet në politikën tonë qeverisëse e cila është miqësore për fëmijët.

Ky dokument i hartuar do të shërbejë si dokument pune për ekipin komunal për të drejtat e fëmijës, si organ i themeluar së voni nga komuna për të mbarështuar politikën dhe praktikën në lidhje me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës. Plani i punës është hartuar në përputhje me praktikën e promovuar të qyteteve mike për fëmijë dhe përmban fusha të ndryshme të veprimit, të nevojshme për të siguruar realizimin e të drejtave të fëmijës dhe mbrojtjen e tyre.

Procesi i hartimit të planit të punës ka qenë proces dinamik dhe me pjesëmarrje të gjerë, përfshirë sektorët komunalë, institucionet qendrore, si dhe vetë fëmijët e organizuar.

Disa nga veprimet që i kanë paraprirë hartimit të kësaj strategjie janë:

- Janë organizuar konsultime paraprake me palë të ndryshme që kanë ndihmuar në mbledhjen e informatave themelore dhe përgatitjen e procesit të planifikimit;
- Është organizuar një punëtori dyditësh e planifikimit me pjesëmarrje, ku janë identifikuar fushat e veprimit, si dhe është përcaktuar logjika e intervenimit;
- Është organizuar konsultimi me përfaqësuesit e fëmijëve dhe qytetarëve.
- Është mbajtur një takim përcjellës me një grup të ngushtë punues në nivel komunal për të validuar përmbajtjen e planit të punës.

## KONTEKSTI GLOBAL, NACIONAL E LOKAL

Padyshim se Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës<sup>1</sup> është bazamenti i secilit veprim në fushën e të drejtave të fëmijëve. Parimet e saj janë të përqafuara në politika ndërkombëtare që prekin jetën e fëmijëve, por edhe në politikat vendore e lokale. Detyrimisht, edhe ky plan i punës është ndërtuar mbi parimet udhëheqëse të Konventës.

Në nivel vendi veprimi për të drejtat e fëmijës dhe mbrojtjen e fëmijës është planifikuar përmes strategjive. Kështu, sikurse strategjitë pararendëse, edhe Strategjia për të Drejtat e Fëmijës 2019 – 2023<sup>2</sup> përcakton obligimin e autoriteteve në nivelin vendor dhe lokal për qeverisje që mundëson realizimin e të drejtave të fëmijëve. Objektivi i dytë strategjik në këtë strategji kërkon që qeverisja lokale t'i prioritetizojë të drejtat e fëmijëve, duke synuar përmirësimin e jetës së fëmijëve brenda juridiksionit të tyre në përputhje me obligimet që rrjedhin nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës dhe korniza ligjore vendore.

Në Kosovë, për një kohë të gjatë ka munguar ligji për mbrojtjen e fëmijës. Në vitin 2019 ky ligj është miratuar dhe i ka hapur rrugën operacionalizimit të tij përmes akteve nënligjore dhe krijimit e funksionimit të mekanizmave mbrojtës për fëmijët. Kështu Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës<sup>3</sup> ndër të tjera përcakton që Ekipi për të Drejtat e Fëmijës krijohet në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës në nivel të vendimarrjes politike. Në nenin 20 jepen edhe konturat e fushëveprimit të këtij ekipi. Në vitin 2022, Qeveria e Kosovës ka nxjerrë udhëzimin administrativ 06/2022<sup>4</sup> për themelimin dhe funksionimin e ekipit për të drejtat e fëmijës, që përcakton mënyrën e themelimit dhe aspektet e funksionimit të këtij ekipi.

Kryetari i Komunës, në përputhje me UA 06/2022, më 23 dhjetor 2022 ka nxjerrë vendim për themelimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës. Mbledhja konstitutive për themelimin e Ekipit është mbajtur me datë 27 dhjetor 2022.

## PARIMET DHE VLERAT

Në Komunën e Hanit të Elezit promovohet modeli i qeverisjes lokale që u shërben njësoj të gjithë qytetarëve të vet, duke u ofruar në të njëjtën kohë mundësi të gjithëve të shprehin potencialin e tyre dhe të kontribuojnë aktivisht në mirëqenien e përgjithshme shoqërore. Një model i këtillë promovohet edhe në raport me fëmijët. Ata nuk janë marrës pasivë të shërbimeve të të rriturve por anëtarë aktivë të komunitetit. Si të tillë edhe trajtohen, duke i përfshirë në proceset komunale që lidhen me jetën e tyre dhe duke krijuar kushtet që të zhvillojnë gjithë potencialin e tyre. Si ekip e si komunë, jemi të përcaktuar që proceset në komunë të jenë jo vetëm “për fëmijët” por edhe “me fëmijët”.

Në punën tonë si ekip, udhëhiqemi nga parimet themelore të të drejtave të fëmijëve të cilat janë të gdhendura në Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Fëmijës:

- **Mosdiskriminimi** - të gjithë fëmijët duhet t'i gëzojnë të gjitha të drejtat. Asnjë fëmijë nuk duhet tavuaj diskriminimin mbi çfarëdo baze.
- **Interesat më të mira të fëmijës** - kur merren vendime që ndikojnë në fëmijët, interesave më të mira të fëmijës duhet t'u jepet vëmendje parësore.

<sup>1</sup><https://www.unicef.org/montenegro/media/9291/file/MNE-media-MNEpublication505.pdf>

<sup>2</sup><https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/Alb-Track-Changes-Strategjia-per-te-drejtat-e-femijeve-FINAL-12032019.pdf>

<sup>3</sup><https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20844>

<sup>4</sup><https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61596>

- **Jeta, mbijetesa dhe zhvillimi** – të gjithë fëmijëve duhet t’u sigurohet mbijetesa dhe zhvillimi deri në masën më të madhe të mundshme. Zhvillimi përfshin edhe dimensionin e cilësisë: jo vetëm shëndeti fizik, por edhe zhvillimi mental, emocional, kognitiv, social dhe kulturor.
- **Pikëpamjet e fëmijës** - fëmijët duhet të jenë të lirë të shfaqin pikëpamjet lidhur me çdo çështje që ndikon në ta dhe këtyre pikëpamjeve duhet t’u jepet peshë e duhur në përputhje me moshën dhe pjekurinë e fëmijëve.

Ndërtimin e komunës mike për fëmijë e ushqejmë përmes **vlerave të përbashkëta**. Këto vlera lidhen me komunën ku fëmijët:

- Dëgjohen dhe kanë ndikim;
- Janë të mbrojtur nga dhuna e keqtrajtimit;
- Ndihen të sigurt;
- Luajnë e argëtohen;
- Përfshihen lirisht;
- Krijojnë miqësi dhe ndihen të lidhur me komunitetin;
- Kanë mundësi për të mësuar dhe për të zhvilluar shkathhtësitë;
- Ndihen të respektuar;
- Krijojnë ndjenjën e përgjegjësisë ndaj vetes dhe të tjerëve.

## QËLLIMI JONË

**Krijimi i një sistemi qeverisës komunal që siguron mbrojtjen, zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijëve të komunës, përmes bashkërendimit të të gjithë sektorëve komunalë dhe bashkëpunimit me të gjitha palët.**

Ne do të ofrojmë një model të qeverisjes lokale që si konsideratë mbizotëruese do t’i ketë interesat më të mira të fëmijëve të komunës. Përmes bashkërendimit të punëve të të gjithë sektorëve komunalë, do të ofrojmë shërbime shumëdimensionale për fëmijët. Në të gjitha fushat e veprimit do të krijojmë lidhje bashkëpunimi me partnerët dhe komunitetin, që fëmijëve t’u krijojmë një mjedis jetësor të këndshëm dhe mundësues. Vëmendje të vazhdueshme do t’i kushtojmë përfshirjes aktive të vetë fëmijëve në të gjitha proceset vendimarrëse në komunë që lidhen me jetën e tyre. Jemi të bindur se vetëm kështu fëmijët tanë do të bëhen qytetarë të ndërgjegjshëm.

## FUSHAT E VEPRIMIT

Janë identifikuar gjashtë fusha të veprimit në kuadër të planit të punës. Këto fusha, ndonëse janë të veçanta, në asnjë mënyrë nuk mund të adresohen si të vetme. Përkundrazi ato janë të lidhura ngusht në mes veti dhe e plotësojnë njëra-tjerën, duke e bërë planin e punës koherent e gjithëpërfshirës.

1. Shërbimet cilësore për fëmijë

2. Vetëdijesimi dhe avokimi për fëmijë

3. Hapësirat e sigurta e miqësore për fëmijë

4. Sporti, loja dhe rekreacioni për fëmijë

5. Pjesëmarrja e fëmijëve

6. Koordinimi, vlerësimi e raportimi

## OBJEKTIVAT, MASAT E VEPRIMET

Këto fusha prioritare, janë përkthyer në objektiva strategjike dhe më tutjepërmbajnë masa që përmbushin këto objektiva. Secila masë brenda objektivit përkatës është zbrëthyer më tutje në veprime konkrete, që shërbejnë si udhërrëfim në fazën e zbatimit të planit të punës.

### OBJEKTIVI 1: Ofrimi i shërbimeve cilësore gjithëpërfshirëse për fëmijët në komunë

Ne duam t'i përmirësojmë shërbimet e sektorëve si mirëqenie sociale, arsim, shëndetësi, shërbime publike, duke u ofruar fëmijëve të komunës kushtet më të mira të mundshme dhe duke e mbështetur zhvillimin e plotë të fëmijëve. Në këta sektorë respektivë do të identifikohen nevojat specifike dhe llojet e shërbimeve bazë të cilat duhet të përmirësohen apo edhe shërbimet shtesë. Vëmendje e veçantë do t'u kushtohet kategorive të fëmijëve që kanë më së shumti nevojë siç janë fëmijët nga familjet që janë përfitues të skemës së ndihmës sociale, fëmijë me aftësi të kufizuara, fëmijët në rrethana të jashtëzakonshme, etj.

Krahas ofrimit të shërbimeve për fëmijët, do të ofrohet mbështetje për familjet dhe komunitetin përmes edukimit, sikurse edhe do të zhvillohen kapacitetet e profesionistëve të fushave të ndryshme që ta përmirësojnë cilësisë e shërbimeve që ofrojnë.

#### 1.1 Krijimi i një sistemi informues shumëdimensional për llojet e shërbimeve sociale në komunë

Do të krijohet një sistem për të mbajtur publikun të informuar për të gjitha shërbimet që ofrohen në komunë. Fillimisht do të bëhet evidentimi i të gjitha shërbimeve ndaj fëmijëve. Më tutje do të zhvillohet një katalog i llojeve të shërbimeve sociale që ofrohen dhe i ofruesve të shërbimeve. Do të organizohet një fushatë informuese përmes institucioneve publike, medias lokale dhe ueb faqesë komunës e kanaleve tjera të komunikimit.

#### 1.2 Ndarja e fondit për fëmijët në rrethana të jashtëzakonshme

Fëmijët që gjenden në rrethana të jashtëzakonshme kërkojnë përkrahje institucionale në kuptim të ofrimit të shërbimeve profesionale, por edhe ofrimit të shërbimeve logjistike, siç janë ushqimi, transporti, akomodimi, etj. Për këtë arsye do të ofrohet një financim



emergjent për këta fëmijë dhe do të krijohet një sistem për menaxhimin ekëtij financimi dhe këtyre shërbimeve emergjente. Do të evidentohen nevojat për shërbime emergjente dhe do të kontraktohen operatorët ekonomikë për ofrimin e këtyre shërbimeve.

### **1.3 Fuqizimi i konceptit të familjeve strehuese dhe farefisnore**

Koncepti i familjeve strehuese dhe farefisnore është provuar si i suksesshëm, prandaj edhe është i paraparë me Ligjin për mbrojtjen e fëmijës. Ne do ta promovojmë si shërbim dhe do të ndërmarrim një fushatë për të rritur numrin e këtyre familjeve. Do të bëjmë identifikimin dhe vlerësimin e familjeve strehuese dhe farefisnore dhe do të trajnojmë këto familje. Trajtimi i fëmijëve brenda këtyre familjeve do të monitorohet.

### **1.4 Përkrahja në ekzekutimin e masave të diversitetit, masave edukative dhe dënimeve për fëmijë që kanë rënë në konflikt me ligjin**

Ndonëse ekzekutimi i masave të diversitetit është në kompetencë të shërbimit sprovues, komuna do të ofrojë përkrahjen në këtë drejtim. Prandaj do të lidhet një memorandum i mirëkuptimit mes komunës dhe shërbimit sprovues dhe do të mbahet një komunikim intenziv për lehtësimin e procesit e adresimit të nevojave të fëmijëve në konflikt me ligjin.

### **1.5 Zhvillimi i praktikave të prindërimit të mirë dhe disiplinimit pozitiv**

Modulet ekzistuese të prindërimit të mirë do të përshtaten për nevoja të komunitetit. Po ashtu, do të krijohen kapacitetet njerëzore për ofrimin e moduleve të trajnimit dhe do të shpërndahen praktikat e prindërimit të mirë përmes trajnimeve e sesioneve të informimit.

### **1.6 Krijimi i mundësive të barabarta për të gjithë fëmijët për ta regjistruar, vijuar dhe përfunduar shkollën**

Arsimi i obligueshëm nënkupton që çdo fëmijë i moshës shkollore ta vijojë shkollimin. Megjithatë, edhe në komunën tonë ballafaqohemi me raste të mosregjistrimit, mosvijimit të rregullt dhe braktisjes së shkollimit. Ne do të marrim masa për gjithëpërfshirje në shkollim. Do të krijohet një sistem i komunikimit mes shkollave dhe zyrave të regjistrimit civil për t'i marrë të dhënat e fëmijëve të moshës shkollore nga zona që gravitojnë shkollat, në mënyrë që të lehtësohet procesi i regjistrimit në shkollë. Shkollat do të mirëmbajnë bazën e të dhënave me të dhëna për nxënësit sipas modelit të Sistemit të Menaxhimit të Informatave në Arsim (SMIA). Më tutje, do të funksionalizohen Ekipe për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit (EPRBM), si dhe do të bashkëpunohet ngushtë me organizatat që punojnë në fushën e gjithëpërfshirjes në arsim.

### **1.7 Ofrimi i shërbimeve profesionale nëpër shkolla**

Do të trajnohen mësuesit për identifikimin e hershëm të fëmijëve në nevojë për shërbime profesionale pedagogjike dhe psikosociale dhe krijohet mekanizmi për referimin e fëmijëve në nevojë për shërbime profesionale. Po ashtu do të identifikohen nevojat për mësues mbështetës për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe do të angazhohen këta mësues në shkollat e komunës.

### **1.8 Inspektimi i cilësisë së hapësirave shkollore**

Gjendja e objekteve shkollore ndikon shumë në cilësinë e arsimit. Prandaj, ekipe profesionale do ta inspektojnë gjendjen shkollore (inspektim e objekteve, sanitarisë, hapësirave për lojë e rekreacion, pajisjeve shkollore, etj). Këto ekipe do të inspektojnë objektet shkollore në baza vjetore dhe do të dalin me raporte vlerësuese. Mbi bazën e raporteve ndërmerren masa përmirësuese me qëllim të krijimit të objekteve dhe mjediseve shkollore miqësore për fëmijë. Standardet e shkollave mike për fëmijë do të promovohen vazhdimisht.

## **1.9 Krijimi i mekanizmave brenda shkollave për mirëmbajtje të mjediseve shkollore**

Kultura shkollore duhet ta ketë pjesë të veten të vazhdueshme mirëmbajtje e objekteve shkollore. Prandaj për të siguruar angazhimin e të gjitha palëve në shkollë në këtë drejtim, do të vetëdijesohen nxënësit dhe palët tjera për nevojën e mirëmbajtjes dhe kujdesin ndaj mjedisit shkollos. Do të hartohet një udhëzues me praktika të mira të mirëmbajtjes së hapësirave shkollore. Çdo vit do të ndahen shpërblime për komunitetet më të veshme shkollore.

### **1.10 Promovimi shëndetësor, përmes informimit, komunikimit dhe edukimit**

Do të promovohet shëndeti përmes fushatës vetëdijesuese për shëndetin dhe të ushqyerit e foshnjave, fëmijëve dhe adoleshentëve, si dhe përmes edukimit shëndetësor të qytetarëve e ligjëratave për edukimin shëndetësor dhe reprodutiv për nxënësit e shkollave. Po ashtu, do të organizohen ligjërata për parandalimin e abuzimit me substanca.

### **1.11 Organizimi i vizitave multidisiplinare shëndetësore për fëmijët, në baza periodike**

Do t'i kushtohet kujdes ofrimit të shërbimeve të individualizuara shëndetësore për secilin fëmijë. Prandaj do të zhvillohen kapacitetet e profesionistëve shëndetësorë për kujdes shëndetësor ndaj nënës dhe fëmijës, këshillim për të ushqyerit e foshnjave dhe fëmijëve të vegjël dhe përkrahje të zhvillimit në fëmijërinë e hershme. Do të organizohet shërbimi i vizitave sistematike nëpër shtëpi, të cilat do të kenë përveç komponentit të intervenimit shëndetësor edhe atë edukativ. Do të zbatohen praktikat efektive të kujdesit perinatal dhe vizitave për nënat dhe fëmijët. Kontrollat sistematike shëndetësore do të realizohen edhe nëpër shkolla.

### **1.12 Identifikimi i hershëm i fëmijëve me nevoja të veçanta**

Do të përditësohet baza e të dhënave për fëmijët me nevoja të veçanta. Do të promovohen shërbimet institucionale dhe ato të ofruesve të tjerë të shërbimeve për fëmijë me nevoja të veçanta, me fokus në përfitimet e FNV dhe familjeve të tyre.

Do të zhvillohet një formular për deklarin e prindit për gjendjen shëndetësore të fëmijës, si parakusht për regjistrim në shkollë. Për ata fëmijë që kanë parametra që identifikojnë nevojën për kontroll më të hollësishëm, do të ndërmerren këto kontrole dhe do të rekomandohen masat që duhet ndërmarrë shkolla (mësimdhënësit, menaxhmenti i shkollës, prindërit)

### **1.13 Ofrimi i shërbimeve të veçanta për kategoritë e fëmijëve në nevojë**

Do të ofrohen shërbime shumëdimensionale dhe rehabilitim i bazuar në bashkësi për FNV, përmes subvencionimit të organizatave të licencuara për ofrimin e këtyre shërbimeve. Do t'i kushtohet kujdes sigurimit të qasjes fizike të fëmijëve me aftësi të kufizuara në hapësirat publike. Më tutje do të ofrohen programe të mbështetjes shtesë për fëmijët nga grupet e cënueshme (komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, fëmijët në situatë rruge/lëmshëkërkuesit, fëmijët që punojnë, fëmijët e trafikuar, etj.).

## **OBJEKTIVI 2: Zbatimi i programeve të vetëdijesimit dhe avokimit për mirëqenien e fëmijëve**

Ne duam që në bashkëpunim me partnerët tanë, të krijojmë një sistem efektiv për të vetëdijësuar të rriturit, por edhe vet fëmijët për të drejtat e fëmijëve, mirëqenien e tyre dhe për komunën mike për ta. Programet për informim dhe zhvillim profesional për të gjitha palët duke përfshirë edhe politikëbërësit e zyrtarët më të lartë komunalë, janë të njëjta rëndësia të

veçantë. Në të njëjtën kohë, ne do t'i inkurajojmë organizatat e shoqërisë civile, agjencitë e pavarura që të avokojnë për fëmijët. Ndërkaq, do të shfrytëzohet edhe media për promovimin e të drejtave të fëmijës.

## **2.1 Ngritja e kapaciteteve të politikëbërësve dhe zyrtarëve komunalë për aspekte të të drejtave të fëmijëve.**

Me rëndësi konsiderohet që politikëbërësit dhe zyrtarët komunalë si bartës të funksioneve, të jenë mirë të informuar dhe të kenë aftësi vlerësimi e gjykimi për aspekte të të drejtave të fëmijëve. Prandaj, do të organizohen trajnime për tanë temat e njohjes dhe promovimit të të drejtave të fëmijëve, instrumenteve ndërkombëtare, legjislacionit dhe rregullativës që lidhet me të drejtat e fëmijëve, vlerësimin dhe raportimin të gjendjes së fëmijëve, standardeve të operimit, investimit publik në fëmijë, etj.

## **2.2 Organizimi i fushatave vetëdijesuese për të rriturit dhe për fëmijët**

Qytetarët duhet të vetëdijesohen për atributete komunës mike për fëmijë dhe të aktivizohen si qytetarë të përgjegjshëm. Prandaj, do të organizohen fushata vetëdijesuese për të rritur dhe fëmijë. Fushatat do të përfshijnë ligjëratat publike, shpërndarjen e materialit promovues, ofrimin e trajnimeve me profesionistë të fushave të ndryshme si dhe me prindër, etj. Ndërsa fëmijëve do t'u ofrohen programe për të drejtat e njeriut dhe qytetarinë demokratike brenda kurrikulit shkollor dhe përmes edukimit joformal.

## **2.3 Mbështetja e organizatave joqeveritare dhe institucioneve të pavarura në avokimin për të drejtat e fëmijës**

Ne do të jemi transparentë dhe të gatshëm për të shqyrtuar e për adresuar opinionet e të gjitha palëve, lidhur me qeverisjen komunale. Në vështrim të veprimit të përgjegjshëm karshi fëmijëve, do t'i mbajmë dyert e hapura për organizatat joqeveritare, koalicionet e rrjetet që monitorojnë, promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e fëmijëve. Për më shumë, do të përkrahet puna e tyre. Po ashtu do të mundësohet dhe përkrahet puna e vetë organizatave të fëmijëve dhe të rinjve në avokimin për të drejtat e tyre.

## **2.4 Promovimi i të drejtave të fëmijës përmes medias**

Shfrytëzimi i medimeve të ndryshme për të gjeneruar lajme të përgjegjshme për fëmijët dhe në interesin më të mirë të tyre është shumë i rëndësishëm. Për të siguruar këtë, do të ofrohen udhëzues dhe trajnime për zyren komunale për marrëdhënie me publikun, për sekretariatit e ekipit si dhe për mediat e profesionistët e mediave të shkruara dhe elektronike.

## **OBJEKTIVI 3: Krijimi i hapësirave publike të sigurta dhe miqësore për fëmijët**

Ne duam që hapësirat në të cilat frekuentojnë fëmijët të jenë plotësisht të parrezikshme për ta dhe t'u krijojnë atyre ndjenjën e sigurisë në çdo kohë, edhe atëherë kur janë vetëm. Komuna do të përfshijë aktivisht fëmijët dhe prindërit në konsultime gjatë rregullimeve urbanistike, do të përmirësojë higjienën kolektive, do të krijojë kushte për qarkullim të lirë e trafik të sigurt, do të shmang rreziqet në hapësira publike dhe do të krijojë mjedis ekologjik.

### **3.1 Përmirësimi i higjienës kolektive**

Që fëmijët tanë të rriten në një mjedis të pastër do të identifikohen lagjet pa sistem të menaxhimit të ujërave të zeza dhe do të zbatohen projekte për menaxhimin e tyre. Po ashtu do të mirëmbahet dhe aty ku ka nevojë të përmirësohet shërbimi i grumbullimit të mbeturinave në hapësira publike dhe nëpër familje. Ndërsa do të identifikohen pjesët që nuk janë të mbuluara me ujësjellës dhe do të shtrihet ujësjellësi në ato pjesë, apo të përkrahen në sigurimin e ujit të pijes prej burimeve alternative.

### **3.2 Sigurimi i sistemit të trafikut që është i sigurt dhe miqësor për fëmijët**

Për të përmirësuar këtë situatë, do të hartohen dhe zbatohen projekte për lirim të trotuareve dhe vendkalimeve për këmbësorë, vendosjen e shenjave të vendkalimeve, vendosjen e barrierave, etj. Edhe projekti për shtigjet e biçiklistëve do të hartohet e të realizohet. Ndërkaq, me të gjithë pjesëmarrësit në trafik do të ndërmerret një fushatë informimi për sigurinë në trafik.

### **3.3 Eliminimi i rreziqeve dhe krijimi i mjedisit ekologjik**

Hapësirat publike shpesh përbëjnë rrezik për fëmijët, për shkak të dëmtimeve të këtyre hapësirave. Prandaj, do të monitorohen në mënyrë sistematike hapësirat publike për të identifikuar rreziqet eventuale për fëmijët (shtretërit e lumenjve, deponitë, rrënojat, gropat e pusetat e pambuluara, trotuarët e vendkalimet e pashenjuara, lodrat për fëmijë, etj.) dhe do të merren masa për eliminimin e tyre. Komuna do të mbështetet edhe në ndihmën e publikut në raportimin e rreziqeve të tilla. Kështu, do të lansohet e mirëmbahet një kanal për publikun për raportimin e rreziqeve si dhe do të merren masa për eliminimin e tyre në afat sa më të shkurtër.

Për shkak të koncentrimin të madh të fëmijëve rreth shkollave, do të merren masa për të parandaluar rreziqet përreth shkollës, që mund të vijnë nga prania e personave të paautorizuar, shitja e artikujve të dëmshëm, etj. Po ashtu në nivel komune dhe në bashkëpunim edhe me nivelin qendror do të bëhet sistemimi i qenve endacakë

Më tutje do të ndërmarren veprime të rritjes së hapësirave të gjelbra e parqeve në qytet, si dhe pyjeve në pjesën rurale.

## **OBJEKTIVI 4: Zhvillimi i fëmijëve përmes sporteve, lojës dhe rekreacionit**

Loja, rekreacioni dhe sporti janë elemente të rëndësishme të zhvillimit të fëmijëve dhe segmente ku ata shfaqin talentet e tyre. Prandaj, do të promovohet pjesëmarrja e fëmijëve nëpër klube sportive e institucione kulturore. Shkollat do të jenë institucionet që përtej kurrikulit formal do të krijojnë hapësirën dhe mundësitë për aktivitete të kohës së lirë, rekreacion e sport për nxënësit. Po ashtu, shkollat do të krijojnë lidhjet me klubet sportive, klubet artistike e kulturore, në mënyrë që fëmijët të mund t'i zhvillojnë më tutje talentet e tyre në fushat në të cilat kanë interesim. Hapësirat publike do të adaptohen që të sigurojnë argëtim e kohë të lirë për fëmijët nëpër lagje.

### **4.1 Promovimi i sportit nëpër shkolla**

Në nivel të shkollave do të zhvillohen kapacitetet njerëzore që do të marrin përgjegjësinë e promovimit të sportit shkollor. Do të krijohen klubet sportive në nivel të shkollave dhe do të organizohen gara shkollore në sporte të ndryshme. Rëndësi do t'i kushtohet përfshirjes gjinore dhe thyerjes së stereotipeve gjinore.



#### **4.2 Funksionalizimi i klubeve sportive të kategorive të reja**

Do të punohet me klubet sportive ekzistuese në aktivizimin e klubeve për kategoritë e reja për vajza dhe djem. Për të rekrutuar fëmijë dhe të rinj në klube, do të bashkëpunohet me shkollat dhe do të mbahen kampe për identifikimin e talenteve.

#### **4.3 Promovimi i artit, kulturës dhe teknologjisë**

Do të ofrohen programe artistike e kulturore nëpër shkolla, ku fëmijët do të demonstrojnë shkathësitë e tyre. Klubet artistike e kulturore të shkollave do të lidhen me organizata të artit e kulturës si teatro, ansamble të këngëve e valleve, klube letrare, etj., për të ofruar mundësi shtesë për fëmijët që kanë afinitet në këto fusha. Po ashtu, do të përkrahen shkollat dhe institucionet në promovimin e hapësirave për programim, kodim, ueb dizajn, etj. Praktika të tilla tashmë janë instaluar në nivel të shkollave, dhe do të zhvillohen më tutje.

#### **4.4 Ofrimi i hapësirave joformale për rekreacion**

Lagjet tona duhet të ofrojnë hapësira të rekreacionit ku fëmijët mund të çlodhen e shoqërohen. Për këtë arsye, do të inspektohet situata me parqet ekzistuese dhe do të identifikohen nevojat për hapësira shtesë për lojë. Më tutje, do të intervenohet në adaptimin e hapësirave ekzistuese për lojë dhe në ndërtimin e hapësirave të reja. E gjithë kjo do të bëhet në përputhje me standardet e hapësirave të sigurta e mike për fëmijë. Do të krijohet një partneritet mes komunës dhe komunitetit duke krijuar ekipet e përbashkëta për mirëmbajtjen e hapësirave rekreative. Për t'i kthyer këto hapësira komunitare në hapësira përfshirëse, do të bëhet identifikimi i nevojave për rekreacion i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe përfshirja e tyre në parqet ekzistuese.

#### **4.5 Angazhimi i fëmijëve në aktivitete të lira dobiprurëse për komunitetin**

Po aq me rëndësi është që fëmijëve t'u ofrohen mundësi që këtë kohë rekreacioni ta shfrytëzojnë për aktivitete që janë me përfitim për komunitetin. Kësisoj ata i zhvillojnë vlerat qytetare dhe përgjegjësinë për komunitetin. Komuna do të përkrah organizimin e kampeve me fëmijë dhe të rinj nga shkollat e ndryshme, por edhe atyre nga organizatat e fëmijëve. Këto kampe do të jenë të natyrës rekreative, edukative, mjedisore, etj. Do të organizohen vizita e takime edukative e kulturore në institucionet që mbrojnë të drejtat e fëmijëve. Më tutje, do të bëhet angazhimi i fëmijëve dhe të rinjve në aktivitete në përfitim të komunitetit si mbjellja e drunjëve, ofrimi i ndihmës së parë, evakuimi, siguria në trafik, etj.

**OBJEKTIVI 5: Sigurimi i pjesëmarrjes së fëmijëve në proceset vendimmarrëse për çështjet që lidhen me jetën e tyre**

Ne duam që fëmijët, në varësi të kapacitetit të tyre, të marrin pjesë aktivisht në vendimet për komunën, sidomos në ato që lidhen drejtpërdrejt me jetën e tyre. Do të ndihmojmë edhe familjet që të ndjekin këtë qasje që nga fëmijëria e hershme, kurdo që vendoset për jetët e fëmijëve të tyre. Institucionet arsimore kanë një rol të madh në fuqizimin e fëmijëve në pjesëmarrje. Strukturave përfaqësuese të fëmijëve në nivele të ndryshme do t'u ofrohet hapësirë veprimi dhe përkrahje nga të rriturit në zhvillimin e kapaciteteve të tyre. Organet vendimmarrëse në të gjithë sektorët e komunës do të ndjekin procedurat e konsultimeve me fëmijë para se të marrin vendime që ndikojnë në jetën e fëmijëve.

## **5.1 Përcaktimi dhe zbatimi i procedurave të konsultimit me fëmijët me rastin e vendimmarrjes**

Do të përcaktohen procedurat për konsultimin e fëmijëve për të gjitha palët në komunë që marrin vendime për fëmijët dhe në përgjithësi për qytetarët e komunës. Këto procedura do të paraqiten përmes njëudhëzuesi praktik. Më tutje do të organizohen sesione informimi për procedurat e konsultimeve me fëmijë, në mënyrë që këto procedura të përvetësohen nga të gjithë. Do të monitorohet zbatimi i procedurave të konsultimit me fëmijë nga të gjithë sektorët komunalë me rastet e hartimit të projekteve zhvillimore, strategjive e planeve të veprimit, me rastin e planifikimit të buxhetit, etj.

## **5.2 Fuqizimi i organeve përfaqësuese të fëmijëve**

Këshillat e nxënësve janë organe të nxënësve të parapara me ligj. Ndonëse ato janë të themeluara në të gjitha shkollat, funksionimi i tyre duke përfshirë mënyrën e përzgjedhjes dhe mandatin e angazhimit të tyre është larg prej standardeve të përfaqësimit demokratik. Prandaj, do të nxitet funksionimi i rregullt i organeve përfaqësuese të nxënësve në të gjitha nivelet, duke filluar nga këshillat e nxënësve nëpër klasa, dhe themelimin e Asamblesë Komonale të Fëmijëve. Këto organe duhet të jenë gjithëpërfshirëse në kuptim të përfaqësimit gjinor, gjeografik, etnik, të aftësive, etj. Më tutje, do të zhvillohen kapacitetet e fëmijëve për pjesëmarrje demokratike në jetën shkollore dhe të komunitetit, përmes moduleve të trajnimit për udhëheqje e aktivizim qytetar. Një aspekt qenësor është rregullimi i marrëdhënieve në mes vetë nxënësve. Për këtë arsye do të promovohet ndërmjetësimi në mes moshatarëve si qasje për të adresuar problemet, konfliktet, ngacmimet e dhunën në shkollë, por edhe në lagje. Do të identifikohen fëmijë që mund të angazhohen si ndërmjetësues dhe të trajnohen për aspekte të ndërmjetësimit në mes moshatarëve.

## **OBJEKTIVI 6: Bashkërendimi i veprimeve të të gjitha palëve përmes procesit të koordinimit, si dhe përmes vlerësimit dhe raportimit për gjendjen e fëmijëve në komunë**

Ne duam që i gjithë procesi i zbatimit të planit të punës të refletojë qeverisjen e mirë dhe miqësore për fëmijë. Prandaj, është me shumë rëndësi që ky proces të jetë me pronësi të gjerë, ku të gjitha palët do të bashkërendojnë veprimet me qëllimin që të adresohen masat e definuara me planin e punës. Ndërsa, për të siguruar cilësinë na nevojitet zhvillimi i instrumenteve për vlerësimin e ndikimit në fëmijë, dhe hartimi i raporteve për gjendjen e fëmijëve të komunës.

## **6.1 Vlerësimi i ndikimit në fëmijë dhe raportimi për gjendjen e fëmijëve**

I gjithë procesi i qeverisjes miqësore për fëmijë, i bashkërenduar përmes planit të punës ka nevojë t'i nënshtrohet procesit të vlerësimit të ndikimit që ka në fëmijë. Prandaj, fillimisht do të realizohet një studim bazë lidhur me të gjitha aspektet e qeverisjes, që do të shërbejë për monitorim e vlerësim të zbatimit të planit të punës. Pastaj, do të bëhet vlerësimi periodik i ndikimit të aspekteve të qeverisjes lokale dhe aspekteve të planit të punës për të drejtat e fëmijës. Raportet nga vlerësimi do të diskutohen në nivel të ekipit komunal dhe po ashtu përfshihen në politikat dhe praktikat e qeverisjes lokale.

## **6.2 Koordinimi me palët relevante**

Qasja e bashkëpunimit me të gjitha palët, është parim i punës së qeverisjes komunale në përpjekjen për një komunë mike për fëmijë. Prandaj, do të mbajmë komunikim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me palët e ndryshme si në nivelin lokal (me organizata, grupe joformale, bashkësi lokale, këshilla, etj.), ashtu edhe në nivelin rajonal e qendror (me institucionet qendrore/rajonale që ofrojnë shërbime në nivel komunal, por edhe me vet qeverisjen qendrore) Kjo do të na ndihmojë që të sigurojmë politika të mira për fëmijët, si dhe të kërkojmë përkrahje shtesë nga niveli qendror për nevojat e fëmijëve të komunës.

## **6.3 Vlerësimi dhe raportimi**

